



KOLEGJI UNIVERSITAR  
**BEDËR**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

### **Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

- |                            |          |
|----------------------------|----------|
| 1. Dr. Ana Kekezi          | Kryetare |
| 2. MSc. Kriselda Gura      | Anëtar   |
| 3. MSc. Eduina Maksuti     | Anëtar   |
| 4. MSc. Grasiela Baçellari | Anëtar   |
| 5. Marko Sejdini           | Student  |

Janar/2024



**PËRMBAJTJA**

LETËR SHOQËRUESE .....	3
PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM.....	4
PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM.....	5
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE .....	6
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR .....	11
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT .....	20
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	35
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE .....	44
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR .....	55
PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË "INFORMATIKË EKONOMIKE" .....	61
SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT .....	66
SHTOJCA Tabelat përbledhëse .....	67



## LETËR SHOQËRUESE

### FJALA E DEKANIT PËR PROGRAMIN BACHELOR NË INFORMATIKË EKONOMIKE

Si fakulteti më i ri i Kolegit Universitar Bedër por edhe shumë aspirues për nga profilet e studimit që ofron dhe perspektiva e lëmeve akademike, kërkimore dhe profesionale që mbulon, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit premton të përbëjë një hap të ri cilësor në projektimin dhe arsimimin e profesionistëve të lartë në Shqipëri në fushën e ekonomisë dhe biznesit, teknologjisë, shkencave kompjuterike, si dhe në mbështetje të kërkimit për zhvillim të qëndrueshëm në tërësi. Fakulteti synon që nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale dhe mbështetjen te kërkimi shkencor, të kontribuojë në inovacionin në teknologji, zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e qendrueshëm në nivel kombëtar dhe rajonal, me qëllim përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë.

Me anë të një mësimdhënieje cilësore të bazuar në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave profesionale tek studentët dhe përmes kërkimit shkencor të aplikuar Fakulteti i teknologjisë dhe i Biznesit synon dhe angazhohet të formësojë studentë, qytetarë të denjë dhe profesionistë kontribues në sektorët më strategjik të zhvillimit të shoqërisë shqiptare.

Si njësi kryesore ky fakultet ka në përbërje të tij tre njësi bazë përkatësisht Departamentin Ekonomisë dhe Biznesit, Departamentin e Shkencave Kompjuterike, dhe Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion. Programi aktual i cili po i nënshtronhet procesit të akreditimit periodik Bachelor në Informatikë Ekonomike gjatë rrugëtimit të tij thuhaje tre vjecar nga momenti i licensimit ka synuar që përmes një kurrikule të konceptuar që në zanafillën e saj bashkëkohore dhe përmes ndërthurjes së dimensionit praktik dhe profesional me atë teorik të kontribuojë sa më mirë në përgatitjen e qytetarëve dhe profesionistëve në Ekonomi dhe Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.

Programi është projektuar të pajisë studentët me aftësitë e duhura për të punuar me shumëlojshmëri të dhënat socio-ekonomike si dhe aplikimin e tyre në sistemet informatike. Programi ofron njohuri teorike dhe praktike në financë, kontabilitet, mikro dhe makroekonomi, statistikë, dizajnim i sistemeve të ndryshme informatike, bazat e programimit dhe programimi në Web, menaxhim i bazave të dhëna si dhe formimi dhe implementimi i sistemeve inteligente të përpunimit të dhëna sasi të mëdha. Të gjitha këto lëndë hapin rrugën për shumë profesione dhe për një orientim më të mirë të studentëve drejt tregut të punës.

Përmes aktiviteteve akademike dhe profesionale në formatin e seminareve, workshopave studentore, leksioneve të hapura, webinareve me të ftuar profesionistë të fushës, forumeve apo edhe trajnimeve profesionale njësia bazë ka synuar të sjellë studentët sa më afër kërkeseve dhe risive teknologjike të bizneseve dhe të fushës akademike duke synuar në këtë mënyrë përgatitjen e të diplomuarve të gatshëm për një punësim të menjëherëshëm dhe të suksesshëm në profilin e tyre.

Në mbarëvajtjen e këtij programi gjatë viteve ka kontribuar atashimi pranë programit të lektorëve profesionistë dhe sipërmarrës të suksesshëm në disiplinat më strategjike të ekonomisë, teknologjisë së informacionit dhe përpunimit të dhëna për bizneset. Infrastruktura në mbështetje të programit dhe kryesish laboratori i pajisur me kompjutera eorkstation të fjalës së fundit të teknologjisë kanë bërë që studentët të kenë mundësinë të prekin më nga afér suksesin.

Uroj që ky program të kalojë suksesshëm procesin e akreditimit periodik për të qenë në gjendje të këtë mënyrë të shohim frytin e punës së tre viteve të materializuar në studentë te diplomuar si profesionistë të suksesshëm të cilët do të bëhen edhe promocioni më i mirë i këtij programi.

Prof.Assoc.Dr.Tidita Abdurrahmani

Dekane Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit

Kolegi Universitar Bedër



## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Kolegji Universitar “Bedër” (KU “Bedër”) u licensua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 6.04.2011 (i ndryshuar)<sup>1</sup>për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë. KU “Bedër” është një institucion në fushën e arsimit të lartë, i cili funksionon si organizatë jofitimprurëse. Akreditimi i parë institucional është marrë në vitin 2013 nga APAAL<sup>2</sup> dhe është riakredituar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë dhe ASCAL në vitin 2017<sup>3</sup>. Gjatë vitit akademik 2020 - 2021 institucioni përfundoi me sukses riakreditimin institucional dhe me vendim të Bordit të Akreditimit, nr.57, datë 16.12.2021 u akreditua deri në vitin 2026<sup>4</sup>. Akreditimi i të gjitha programeve të studimit që ofrohen, është një tregues i rëndësishëm i cilësisë dhe standardeve të KU “Bedër”.

Për përbushjen e misionit të tij KU “Bedër” synon vazhdimisht rritjen e cilësisë akademike dhe institucionale, pjesë e vizionit të funksionimit, që nuk synon sasinë, por cilësinë. Duke filluar nga viti akademik 2021–2022, me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 200, datë 3.07.2020, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit është njësi bazë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit.<sup>5</sup> Ky departament vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi në disiplinat e shkencave ekonomike dhe të informatikës. Departamenti aktualisht ofron programet e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” dhe Bachelor në “Financë Kontabilitet”.

Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” u licensua si program studimi me urdhër numër 248, datë 19.07.2021, pranë Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit.<sup>6</sup> Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë dhe kohëzgjatja e studimeve është 3 vite akademike, e shtrirë në 6 semestra. Studentët për t'u diplomuar duhet të realizojnë minimalisht 180 ECTS, të ndara për çdo vit akademik me 60 ECTS të fituara dhe me nga 30 ECTS për çdo semestër. Misioni kryesor i programit është të përgatisë me njohuri dhe aftësi teorike, praktike dhe profesionale individë të kualifikuar, të cilët atu ku do të punësohen, do të kontribuojnë në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë me aftësitë e tyre analitike, shkencore, teknologjike, sociale, financiare dhe kritike në sektorin publik ose privat. Programi i studimit realizohet në gjuhën Angleze, e cila është një vlerë e shtuar, sepse u jep mundësinë studentëve të diplomuar në këtë program studimi të ndjekin lehtësisht programet mobilitetit, të vazhdojnë cikle të tjera studimi jashtë vendit, si dhe të jenë më afër tregut ndërkombëtar të punës.

<sup>1</sup> Evidenca nr. 2: Vendimi për licencimin e Kolegit Universitar “Bedër”

<sup>2</sup> Evidenca nr. 63: Vendimi i Akreditimit Institucional, viti 2013

<sup>3</sup> Evidenca nr. 64: Vendimi i Akreditimit Institucional, viti 2017

<sup>4</sup> Evidenca nr. 65: Vendimi i Bordit të Akreditimit, nr.57, date 16.12.2021 Për akreditimin periodik të IAL KU “Bedër”

<sup>5</sup> Evidenca nr. 7: Riorganizimi i njësisë kryesore në KU “Bedër”

<sup>6</sup> Evidenca nr. 12: Vendimi per hapjen e programit Bachelor në Informatike Ekonomike



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Kolegjit Universitar “Beder”<sup>7</sup>, si dhe urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institacioneve të arsimit të lartë”, nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë, me propozim të Këshillit të Departamentit dhe me vendim të Senatit Akademik u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”<sup>8</sup>.

Në përzgjedjen e anëtarëve të GVB-së janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitet për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes së anëtarëve të grupit. Grupi është ngritur qëllimi përmisionin e vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja ka në përbërjen e tij 5 anëtarë, duke përfshirë edhe përfaqësues të studentëve.

Ky proces akreditimi për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” zhvillohet për herë të parë.

Projekti i raportit të vetëvlerësimit u diskutua në njësi, nga ku dolën mendime dhe sugjerime, të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar.

### Etapat e procedurës së Vlerësimit të Brendshëm, ndjekur për Programin Bachelor në “Informatikë Ekonomike”

- Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit.
- Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL dhe BA.
- Njoftohet zyrtarisht Koordinatori i IAL, për fillimin e procesit të akreditimit, dhe caktohet data e takimit me të për diskutimin e hapave të procesit.
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm; ky grup ngrihet nga titullari i njësisë;
- Trajnimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
- Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesit në fjalë (shih më tej). Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe udhëzohet nga kjo e fundit në rast kërkese.

<sup>7</sup> Evidenca nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar “Beder”

<sup>8</sup> Evidenca nr. 107: Vendim i Senatit Akademik për miratimin e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, programi Bachelor në “Informatikë Ekonomike”

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në "Informatikë Ekonomike"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

#### Standardi I.1

**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Kolegji Universitar "Bedër" (KU "Bedër"), ashtu sikurse përcaktohet edhe në statutin e tij, Neni 4, pika 1 dhe 3, "si një institucion me një mision të quartë në përgatitjen e individëve të kualifikuar nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë, ofron programe studimi, të cilat reflektojnë interesat e priorititet kombejtare të vendit dhe nuk bie ndesh me këto interesa në asnjë element të tij. Për më tepër, traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të ndërthurura me standarde arritjet më të mira, ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato evropiane në veçant"<sup>9</sup>.</p> <p>Sikurse përcaktohet edhe në Planin Strategjik të miratuar me vendim senati<sup>10</sup>, KU "Bedër" ofron programe studimi të cilat organizohen në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga "Karta e Bolonjës" dhe legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë<sup>11</sup>.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartoher dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit janë hartuar në përputhje të plotë me qëllimet, misionin, dhe fushën e veprimtarisë së KU "Bedër"<sup>12</sup>.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është hartuar në përputhje të plotë me misionin e KU "Bedër" me qëllim që të përgatisë të rinj me njohuri të mjaftueshme në të dyja fushat, atë të ekonomisë dhe atë të teknologjisë, të përshtatur me nevojat e tregut konkuruese të punës. Ashtu sikurse përcaktohet tek Propozimi për hapjen e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", ky program synon të formojë profesionistë me njohuri të plota teorike dhe praktike, të cilët do të kontribuojnë në fushat e ekonomisë dhe teknologjisë me aftësitë e tyre analitike, shkencore, teknologjike, sociale, financiare dhe kritike në sektorët publikë dhe privat, vendas dhe të huaj<sup>13</sup>.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartoher dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	<p>Sikurse parashikohet në planin e tij strategjik, "KU "Bedër" ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, sociale, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, duke sjellë një profil të quartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar"<sup>14</sup>.</p> <p>Program i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është hartuar dhe ofrohet bazuar në statutin e KU "Bedër", sipas të cilit, "Në të gjithë veprimtarinë e tij, ky i fundit, ka për qëllim të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor, ndër të tjera në fushën e ... ekonomisë, biznesit, teknologjisë së informacionit, ... duke zhvilluar programe studimi në këto profile"<sup>15</sup>. Ky program mbëshitet në Rregulloren Themelore të KU "Bedër", ku shprehet se, <i>ky rregullorë mbëshitet në</i></p>

<sup>9</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i Kolegit Universitar "Bedër", Neni 4, pika 1 dhe 3

<sup>10</sup> Evidencia nr. 14. Vendimi i Senatit për miratimin e planit strategjik institucional, 2018-2023

<sup>11</sup> Evidencia nr 15: Plani Strategjik Institucional 2018-2023, Kapitulli II, Pika B. 3, fq. 5

<sup>12</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i Kolegit Universitar "Bedër", Neni 4, pika 1 dhe 3

<sup>13</sup> Evidencia nr. 5: Propozim për hapjen e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", Pika a.1. Përvshkrimi i përgjithshëm i programit, Misioni, Qëllimi, Objektivat, fq. 10

<sup>14</sup> Evidencia nr. 15: Plani Strategjik Institucional 2018-2023, Kapitulli II, Pika B. 3, fq. 5

<sup>15</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i Kolegit Universitar "Bedër", Neni 4, pika 2, a



	<p>Ligin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në statutin dhe rregulloren themelore të Kolegit Universitar "Beder", në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, "Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë – (Beder)".<sup>16</sup></p> <p>Programet e studimit të ofruara nga KU "Beder" janë në përputhje me kërkosat e tregut të punës dhe synojnë të kontribuojnë në nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Bazuar në studimin e tregut, në kuadër të propozimit për hapjen e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", dinamikat e arsimit të lartë në Shqipëri, preferencat e maturantëve drejt profileve ekonomike dhe teknologjisë, strategjitet e nevojat kombëtare, si dhe specifikat e ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, miratuar në vitin 2015, KU "Beder" propozoi hapjen e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit<sup>17</sup>.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, njësi bazë pranë Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit. Hapja e këtij programi është bazuar në një analizë të thellë të statistikave më të fundit në lidhje me dinamikat, tendencat dhe nevojat e tregut kombëtar dhe rajonal për ndërthurjen mes ekonomisë dhe teknologjisë<sup>18</sup>.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>KU "Beder" operon prej 12 vitesh në tregun e arsimit të lartë shqiptar, dhe pas riorganizimit, ka si njësi kryesore të tij Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit. Stafi akademik i angazhuar në njësitë bazë pranë Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit: Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, dhe Qendra për zhvillim të Qëndrueshmërinë e burimeve njerëzore të nevojshme për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike"<sup>19</sup>.</p> <p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit ofron dy programe studimi: Bachelor në "Informatikë Ekonomike" dhe Bachelor në "Financë Kontabilitet"<sup>20,21</sup>.</p> <p>Personeli akademik i atashuar pranë Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit është i përbërë nga PAE dhe PAK, të cilët kanë formim të mirëfilltë akademik në fushën e ekonomisë dhe informatikës<sup>22</sup>. Personeli Akademik Efektiv (PAE) mbulon më shumë se 70% të lëndëve të profitit të ekonomisë në programin Bachelor në "Informatikë Ekonomike"<sup>23</sup>.</p> <p>Eksperiencia e personelit me kohë të plotë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe përvojat profesionale në kompani dhe institucione të ndryshme, jepin garancinë për kapacitetet e duhura në realizimin e këtij programi studimi<sup>24</sup>.</p> <p>Gjithashtu, në mësimdhënie pranë programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", janë angazhuar edhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) të cilët janë ftuar për të dhënë kontributin e tyre si profesionistë me përvojë nga institucione të ndryshme publike dhe private.<sup>25</sup> Rekrutimi i stafit me përvojë dhe mbajtja e një raporti të arsyeshëm lektor-student, janë disa nga treguesit e punës së vazhdueshme për ta bërë sa më efektiv programin e studimit.</p>

<sup>16</sup> Evidencia 35, Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", Neni 2

<sup>17</sup> Evidencia nr. 7: Riorganizimi i njësive kryesore në KU Beder

<sup>18</sup> Evidencia nr. 5: Propozim për hapjen e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Pika a.4. Justifikimi i burimeve përgjegjëse

<sup>19</sup> Shtoja: Tabela nr. 1: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë

<sup>20</sup> Shtoja: Tabela nr. 3: Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen nga KU "Beder"

<sup>21</sup> <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/programet-e-studimit-10-4/5/380>

<sup>22</sup> Shtoja: Tabela nr. 1: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë

<sup>23</sup> Shtoja: Tabela nr. 6: 1-2-3, Tabela nr. 7, Tabela nr. 8, Tabelat nr. 12.1-2-3

<sup>24</sup> Evidencia nr. 54: CV-të e stafit akademik

<sup>25</sup> Shtoja: Tabela nr. 6: 1-2-3, Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit



<b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përpunhet plotësish me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit si edhe të Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit. Kjo përputhje është e dukshme, jo vetëm në vetë emërtimin e këtij programi studimi (ndërthurje e Teknologjisë dhe Ekonomisë/Biznesit), por është e parashikuar që në propozimin për risktukturimin e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit <sup>26</sup> . Bazuar në VKM nr. 310 dt. 11.05.2022, për specifikimet dhe përbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë <sup>27</sup> , Këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, ka propozuar kodifikimin e Programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" <sup>28</sup> sipas fushës së gjërë dhe specifike të klasifikuar në këtë vendim si dhe në klasifikimin e UNESCO <sup>29</sup> .			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<span style="background-color: red; color: white; padding: 2px;">Nuk përbushet</span>	<span style="background-color: orange; color: black; padding: 2px;">Përbushjet pjesërisht</span>	<span style="background-color: yellow; color: black; padding: 2px;">Përbushjet kryesisht</span>	<span style="background-color: green; color: white; padding: 2px;">Përbushjet plotësish</span>

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>KU "Bedër", bazuar në Ligjin për arsimin e lartë nr. 80/2015<sup>30</sup>, në Statutin<sup>31</sup> dhe Rregulloren Themelore<sup>32</sup> të institucionit, ka hartuar Rregulloret mbi Organizimin Akademik<sup>33</sup> dhe Administrativ<sup>34</sup>. Qëllimi i këtyre rregulloreve është që, nëpërmjet përcaktimit të organizimit, funksionimit, detyrave, kompetencave, përgjegjësive, si dhe marrëdhënieve ndërmjet njësive, të krijojë një mjedis pune të rregullt dhe harmonik, me qëllim rritjen e rendimentit shkencor<sup>35,36</sup>.</p> <p>Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, i përbahet qasjes së KU "Bedër" dhe ndjek një praktikë të vazhdueshme bashkëpunimi me njësitet akademike dhe administrative<sup>37</sup> për të siguruar mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e punës së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, realizohet ndarja e detyrave dhe koordinimi mes personelit akademik të departamentit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë në këshillimin akademik, realizimin e koordinimit me njësitet dhe zyrat administrative</p>

<sup>26</sup> Evidencia nr. 7: Riorganizimi i njësive kryesore në KU "Bedër"

<sup>27</sup> Evidencia nr. 43: Për specifikimet dhe përbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë

<sup>28</sup> Evidencia nr. 73: Propozime për kodifikimin e programeve të studimit në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit

<sup>29</sup> ISCED 2013 <https://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-fields-of-education-and-training-2013-detailed-field-descriptions-2015-en.pdf>

<sup>30</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/P%C3%ABrmbledhje-e-legislacionit-p%C3%ABr-arsimin-e-lart%AB-%AB-me-11.01.2023-Pdf-2.pdf>

<sup>31</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër,"

<sup>32</sup> Evidencia nr.3. Rregullorja Themelore

<sup>33</sup> Evidencia nr.10: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

<sup>34</sup> Evidencia nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

<sup>35</sup> Evidencia nr. 10: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, Neni 1

<sup>36</sup> Evidencia nr. 11: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ, Neni 1 dhe 2

<sup>37</sup> Evidencia nr. 3: Rregullorja Themelore, neni 18 dhe 40



	dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve shkencore dhe ekstrakurrikulare. <sup>38</sup> Në këtë mënyrë, këshilli i departamentit përcakton këshilltarët akademikë për çdo grup studentësh <sup>39</sup> , përfaqësuesin e departamentit në zyrën e planifikimit të karrierës <sup>40</sup> , zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare <sup>41</sup> , koordinatorët e programeve të studimit <sup>42</sup> dhe asistentin e departamentit pranë NJSBC <sup>43</sup> . Në fillim të vitit të ri akademik, këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, gjithashtu miraton edhe planin e aktiviteteve që ky departament planifikon të realizojë gjatë vitit në vijim <sup>44</sup> si edhe bën kërkesë për mbështetje financiare për realizimin e tyre <sup>45</sup> . Në përfundim të vitit akademik, i gjithë aktiviteti i departamentit analizohet dhe përmblidhet në raportin vjetor të njësisë bazë <sup>46</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucion vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	<p>Në funksion të realizimit të objektivave të programeve të studimit, KU "Bedër" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit<sup>47</sup>, si dhe me aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj<sup>48</sup>. Konkretnisht, në kuadër të këtyre marrëveshjeve, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit dhe Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, ka organizuar konferencën ndërkombëtare ICIBT në partneritet me universitete shqiptare (Universiteti Epoka, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë dhe Universiteti Fan S. Noli në Korçë), rajonale (Kolegji AAB në Kosovë) dhe europiane (University of Economics and Human Sciences in Warsaw).<sup>49</sup> KU "Bedër" si anëtar në shoqatën EUMMAS, në bashkëpunim me 30 universitete të tjera ndërkombëtare, ishte pjesë e konferencës "EUMMAS A2S Conference on Global Social and Technological Development and Sustainability".<sup>50</sup></p> <p>KU "Bedër" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me biznese dhe institucione të ndryshme në vend, të cilët janë aktorë shumë të rëndësishëm në realizimin e objektivave.<sup>51,52</sup></p> <p>Në bashkëpunim me Universitetin e Tor Vergatës në Romë, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit realizoi shkollën verore "Teknologja financiare dhe ligji".<sup>53</sup> Në kuadër të ditës Ndërkombëtare të Telekomunikacionit dhe shoqërisë së informacionit, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin Fan S. Noli, në Korçë dhe Albanian University, kanë organizuar për 2 vite radhazi konferencën studentore "Transformimi Digital në kohën e sfidave".<sup>54</sup></p> <p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, KU "Bedër" ka nënshkruar marrëveshje me institucione të tjera të mirënjohura homologe jashtë vendit (Itali, Poloni, Rumani, Kroaci, etj.) duke mundësuar shkëmbimin e eksperiencave akademike për stafin dhe studentët e tij.<sup>55</sup> Në bazë të këtyre</p>

<sup>38</sup> Evidenca nr. 87 : Mbledhja e Këshillit të Departamentit për ndarjen e detyrate dhe përgjegjësive

<sup>39</sup> Evidenca nr. 74: Caktimi i këshilltarëve akademikë për programet Bachelor, viti akademik 2023-2024

<sup>40</sup> Evidenca nr. 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës

<sup>41</sup> Evidenca nr. 82: Caktimi i asistentit pranë Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare

<sup>42</sup> Evidenca nr. 51: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit

<sup>43</sup> Evidenca nr. 85: Caktimi i asistentit të departamentit pranë NJSBC-së

<sup>44</sup> Evidenca nr. 70: Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2023-2024

<sup>45</sup> Evidenca nr. 21 Kërkesë për mbështetje financiare për konkursin e esesë

<sup>46</sup> Evidenca nr. 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023

<sup>47</sup> Evidenca nr. 75: Lista e marreveshjeve institucionale dhe Erasmus +

<sup>48</sup> Evidenca nr. 75: Lista e marreveshjeve institucionale dhe Erasmus +

<sup>49</sup> <https://icibt.beder.edu.al/>

<sup>50</sup> <https://conference.eummas.net/dubai2023/>

<sup>51</sup> Shpjegat Tabela nr. 5: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese

<sup>52</sup> Evidenca nr. 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione

<sup>53</sup> <https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/announcements/shkolla-verore-teknologja-financiare-dhe-ligji-12/2014>

<sup>54</sup> [https://www.instagram.com/p/Cslh1wFqvDG/?utm\\_source=ig\\_web\\_copy\\_link&igsh=MzRIODBiNéFZA==](https://www.instagram.com/p/Cslh1wFqvDG/?utm_source=ig_web_copy_link&igsh=MzRIODBiNéFZA==)

<sup>55</sup> Evidenca nr. 25: Marrëveshje mobiliteti Erasmus +



Tiranë

	marrëveshjeve departamenti ka konkretizuar një sërë mobilitetesh të stafit dhe të studentëve. <sup>56 57</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institacione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	KU "Bedër" dhe, veçanërisht, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, u kushtojnë rëndësi të veçantë internshipeve dhe praktikave profesionale, sipas programeve përkatëse. Gjatë vitit akademik, studentët nxiten dhe iu ofrohet mundësia të ndjekin internshipe dhe praktika profesionale pranë institacioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme, me të cilat departamenti dhe universiteti kanë marrëveshje bashkëpunimi. <sup>58, 59</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësi përgjegjëse për programin Bachelor në "Informatikë Ekonomike", vlerëson në mënyrë periodike marrëveshjet e lindhura me institacione, kompani dhe organizata të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, si edhe është në investim të vazhdueshëm për zgjerimin e listës së bashkëpunimeve. <sup>60</sup>
<b>Shkalla e përbushjes së standartit</b>	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I</b>	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht <b>X</b>
--	--

<sup>56</sup> Evidencia nr. 104: Shkëmbimi i Studentëve

<sup>57</sup> Evidencia nr. 108: Shkëmbimi i Stafit

<sup>58</sup> Shtoja: Tabela nr. 5: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese

<sup>59</sup> Evidencia nr. 45: Shembull aplikimi praktike

<sup>60</sup> Evidencia nr. 111: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutim dhe analizë mbi pjesmarrjen e studentëve në internshipe



## II. ORGANIZIMI, DREJTAMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

### Standardi II.1

**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i Studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" në KU "Bedër" është një program studimi trevjeçar, plani mësimor i të cilil është i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme (A), lëndë karakterizuese (B), lëndë ndërdisiplinore (C), lëndë plotësuese (D) dhe detyrime përmbyllëse (E),<sup>61</sup> në përputhje të plotë me legjislacionin vendas në fuqi, si edhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<sup>62</sup></p> <p>Çdo lënde i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.3.2021 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".<sup>63</sup></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjërë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<p>Ashtu sikurse parashtronet në propozimin për hapjen e tij, programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është projektuar tu ofrojë studentëve njohuri më të gjëra bashkëkohore e të gjithanshme në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë. Ky program studimi i pajis studentët me aftësitë e duhura për të punuar me shumëlojshmëri të dhënash socio-ekonomike si dhe aplikimin e tyre në sistemet informatike. Programi ofron njohuri teorike dhe praktike në financë, kontabilitet, mikro dhe makroekonomi, statistikë, dizajnim i sistemeve të ndryshme informatike, bazat e programimit dhe programimi në web, menaxhim i bazave të të dhënavë si dhe formimi dhe implementimi i sistemeve inteligente të përpunimit të të dhënavë në sasi të mëdha. Të gjitha këto lëndë hapin rrugën për shumë profesione si analistë ekonomikë ose statistikë, menaxherë, dizajnjues të sistemeve inteligente ekonomike, konsulentë të sistemeve IT, analistë të të dhënavë, etj.<sup>64</sup></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimitaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Neni 14 i rregullores së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike"<sup>65</sup> i përcakton qartësisht veprimitaritë formuese të programit duke i grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Përqindja totale e lëndëve sipas kategorive, është si më poshtë:<sup>66</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● lëndët bazë kanë një peshë 16.67%,</li> <li>● lëndët karakterizuese 52.78%,</li> <li>● lëndët ndërdisiplinore 13.89%,</li> <li>● lëndët plotësuese 13.33% dhe</li> </ul> <p>● detyrimet përmbyllëse kanë 3.33% të veprimitarisë formuese, të cilat janë në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi, si dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.3.2021 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Lëndët e çdo kategorie janë të ndara në module. Çdo moduli i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS<sup>67</sup>, përkatësisht 5 ECTS, praktika profesionale 4 ECTS dhe Mikroteza /Provim Përfundimtar 6 ECTS.</p>

<sup>61</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike

<sup>62</sup> Evidencia nr. 3: Rregullorja Themelore, Neni 55.

<sup>63</sup> Evidencia nr. 62: Vendim nr. 185, datë 25.3.2021, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

<sup>64</sup> Evidencia nr. 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, pika a.1. Përshkrimi i përgjithshëm i programit, Misioni, Qellimi, Objektivat

<sup>65</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Neni 14

<sup>66</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike

<sup>67</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Neni 11.



<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përbyllëse.	Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përbyllëse. Praktika Profesionale është lëndë e detyrueshme me 4 ECTS dhe pjesë e planit mësimor të programit në semestrin e gjashtë. <sup>68</sup> Gjithashtu, gjatë semestrit të fundit (të gjashtë), studentët duhet të realizojnë Provimin Përfundimtar, si lëndë e detyrueshme me 6 ECTS. Studentët me notë mesatare më të lartë se 3.00 mund të zgjedhin të realizojnë Provimin Përfundimtar ose punimin e Mikrotezës, sikurse parashikohet në rregulloren e programit të studimit, neni 15 dhe 19 <sup>69 70</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Sipas Statutit <sup>71</sup> dhe Rregullores Themelore <sup>72</sup> të KU "Bedër" forma e organizimit të studimeve realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Pranimi i studentëve në KU "Bedër" përcaktohet qartë për të gjitha programet e studimit në Statut <sup>73</sup> , Rregulloren Themelore <sup>74</sup> , Rregulloren e Programit të Studimit <sup>75</sup> dhe në akte të tjera të brendshme, në përputhje me Udhëzimin Nr.12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë". <sup>76</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ka një kurrikul të bazuar mbi eksperiençat më të mira të universiteteve që ofrojnë këtë program studimi dhe ka një përbajtje shumë të ngjashme me to. <sup>77 78</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	KU "Bedër" është në proces të kodifikimit të të gjitha programeve të studimit që ofrohen aktualisht. <sup>79</sup> Kodifikimi i programeve të studimit po bëhet në përputhje me përcaktimet e nenit 86 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë", Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 310, datë 11.05.2022 "Për specifikimet dhe përbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", <sup>80</sup> si dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 31, datë 15.11.2022 "Për procedurat në lidhje me kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" <sup>81</sup> .
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të janë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institacioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" nuk ofrohet në bashkëpunim me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë.

<sup>68</sup> Evidenca nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike

<sup>69</sup> Evidenca nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Neni 15 dhe 19

<sup>70</sup> Evidenca nr. 105: Lëndët që do të përfshihen në provimin përfundimtar, Programi Bachelor në "Informatikë Ekonomike"

<sup>71</sup> Evidenca nr 1: Statuti i Kolegit Universitar Bedër, Pjesa E Katërt Organizimi i Studimeve

<sup>72</sup> Evidenca nr 3: Rregullorja Themelore, Kreu 9, Neni 52-56

<sup>73</sup> Evidenca nr. 1: Statuti i Kolegit Universitar Bedër, Neni 69

<sup>74</sup> Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore, Kreu 10, Neni 64

<sup>75</sup> Evidenca nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Neni 5.

<sup>76</sup> Evidenca nr. 113. Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë

<sup>77</sup> Evidenca nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike.

<sup>78</sup> Evidenca nr. 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, pika a.4. Justifikimi i bazuar në zhë dhëna empirike që të verifikueshme për nevojat e hapjes të programit.

<sup>79</sup> Evidenca nr. 73: Propozime për kodifikimin e programeve të studimit në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit

<sup>80</sup> Evidenca nr. 43. Për specifikimet dhe përbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë

<sup>81</sup> Evidenca nr. 114: Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit.



Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi			
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, si njësi kryesore, dhe Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.  Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit është riorganizuar me urdhër nr. 200, datë 3.7.2020 <sup>82</sup> . Si njësi kryesore, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit përbëhet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, Departamenti i Shkencave Komputerike, si dhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion, të cilat ofrojnë një gamë të gjërë akademike të programeve të studimit. <sup>83</sup> Njësia kryesore dhe ajo bazë përbushin detyrimet për vlerësim dhe akreditim brenda afateve kohore.			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Stafi akademik i Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit është i përbërë nga 24 anëtarë personel akademik efektiv, ku 1 anëtar është me titullin Prof. Dr., 3 anëtarë janë me titullin Prof. Asoc. Dr., 4 anëtarë janë me gradën shkencore "Doktor i Shkencave", 6 anëtarë janë në proces doktorature dhe 10 anëtarë janë me gradën "Master i Shkencave", si dhe 1 anëtar staf administrativ. <sup>84</sup>  Ndërkohë, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësi bazë ka në përbërjen e tij: 1 anëtar me titullin Prof. Asoc. Dr., 2 anëtarë me gradën shkencore "Doktor i Shkencave", 2 anëtarë në proces doktorature, 4 anëtarë me gradën "Master i Shkencave" si dhe 1 anëtar personel ndihmës akademik, duke përbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik <sup>85</sup> dhe për realizimin e orëve laboratorike.			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, si njësi bazë, me vendim të Këshillit të Departamentit emëron koordinatorin e programit të studimit çdo vit të ri akademik, <sup>86</sup> i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

<sup>82</sup> Evidencia nr. 7. Riorganizimi i njësive kryesore në Kolegjin Universitar Beder

<sup>83</sup> Evidencia nr. 8: Organigrama e Kolegjit Universitar Beder

<sup>84</sup> Shtoja: Tabelat nr. 1 dhe nr. 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA)

<sup>85</sup> Shtoja: Tabelat nr. 1 dhe 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA)

<sup>86</sup> Evidencia nr. 51: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e koordinatorit të programit të studimit



**Standardi II.3**

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.	Informacioni i detajuar në lidhje me organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", disponohet në kopje fizike nga njësia bazë dhe kryesore dhe depozitohet pranë administratorit të fakultetit <sup>87</sup> dhe koordinatorit të departamentit. <sup>88</sup> Njëkohësisht, ky informacion mund të aksesohet në versionin digjital në sistemin BIS dhe në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë informacioni i përmendur është i disponueshëm në faqen zyrtare të Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit, si pjesë e faqes zyrtare të KU "Bedër". <sup>89</sup> Departamenti gjithashtu zoteron të gjithë informacionin në lidhje me planin mësimor dhe programin e lëndëve të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" paraqiten në formë të detajuar informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. <sup>90</sup> Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përmban 36 lëndë. Llojet e lëndëve dhe pesha e tyre specifike në planin mësimor janë në përputhje të plotë me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018. "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar. Kohëzgjatja normale e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është tre vite akademike të ndara në gjashtë semestra. Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", në 5 semestrat e parë ofron gjashtë lëndë për çdo semestr të me pesë (5) ECTS për çdo lëndë. Në semestrin e gjashtë, studentët marrin katër lëndë të me pesë (5) ECTS, lënda e praktikës profesionale me katër (4) ECTS, dhe Mikroteza/Provimi Përfundimtar me gjashtë (6) ECTS. Numri i krediteve ECTS llogaritet në bazë të ngarkesës së studentit të përcaktuar në planin mësimor të programit të studimit. <sup>91</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Pranimi dhe regjistrimi <sup>92</sup> i studentëve në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", transferimi <sup>93</sup> , si dhe ekuivalentimi i studimeve <sup>94</sup> janë parashikuar në Rregulloren e Programit të Studimit, në Rregulloren e Transferimit të Studimeve, <sup>95</sup> si dhe në guidën e studentit. <sup>96</sup> Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Senati Akademik <sup>97</sup> , dhe brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, dërgohen në MAS, QSHA dhe RASH kriteret e pranimit për programin e

<sup>87</sup> Evidencia nr. 11: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ, Neni 38

<sup>88</sup> Evidencia nr. 11: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ, Neni 39

<sup>89</sup> <https://ecobus.beder.edu.al/>

<sup>90</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike

<sup>91</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Neni 11.

<sup>92</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, neni 5.

<sup>93</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, neni 39.

<sup>94</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, neni 9.

<sup>95</sup> Evidencia nr. 41: Rregullorja për transferimin e studimeve

<sup>96</sup> Evidencia nr. 28: Guida e studentit

<sup>97</sup> Evidencia nr. 22: Vendim Senati mbi kriteret e pranimit të studentëve

<sup>98</sup> Evidencia nr. 10: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, Neni 8, pika 3



	studimit. Kriteret publikohen në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të KU "Bedër", të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit.								
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuar.	Në çdo program të lëndëve të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" janë të paraqitura qartësisht të gjitha informacionet e nevojshme, si titullari i lëndës, tipologja e lëndës sipas klasifikimit, lloji në kurs të detyrueshëm apo me zgjedhje, përbledhja dhe rezultatet e të nxënët; konceptet themelore; numri i orëve të leksioneve, seminareve, punëve të laboratorit, praktikave të ndryshme, puna e pavarur e studentëve, ngarkesa brenda dhe jashtë auditorit për projekte të ndryshme, konceptet kryesore dhe tematikat që do të trajtohen, si dhe format e frekuentimit dhe të kontrollit të dijeve dhe mënyrat e vlerësimit dhe pikëzimit të studentit, sipas formatit të miratuar nga VKM nr. 41, datë 24.01.2018. <sup>99 100</sup>								
<b>Kriteri 5.</b> Përbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit, në fillim të çdo viti akademik, ndjek rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve, për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", të hartuara nga titullarët e lëndëve për përmirësim të vazhdueshëm të lëndëve. Syllabuset e përditësuara ngarkohen në sistemin BIS si dhe dorëzohen të firmosura pranë koordinatores së Departamentit. <sup>101</sup>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënët dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Plani mësimor i këtij programi studimi është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira të universiteteve publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit. Emërtimi, përbajtja e njohurive për secilën lëndë, shpërndarja e ngarkesës mësimore teorike dhe praktike,<sup>102</sup> si dhe praktikat e ndryshme si brenda planit mësimor ashtu edhe ato ekstrakurrikulare, u mundësojnë studentëve marrjen e njohurive teorike dhe praktike për vazhdimin e studimeve të mëtejshme ose kalimin me lehtësi nga auditorët në tregun e punës shqiptar dhe ndërkombëtar<sup>103</sup>.</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" janë parashikuar lëndë, të cilat ofrojnë njohuri teorike dhe praktike bazë, të lidhura me fushën e ekonomisë dhe informatikës: Financë, Kontabilitet, Mikro dhe Makroekonomi, Menaxhim, Marketing, Bazat e Programimit dhe Programimi në Web, Menaxhim i Bazave të të Dhënave, Statistikë, si edhe lëndë të profitit juridik. Gjithashtu, studentët aftësohen në metoda të kërkimit shkencor përmes lëndëve të tillë si Shkrim Akademik dhe Metoda Kërkimi të cilat u nevojiten edhe për vijimin e studimeve të tyre.</p> <p>Në të gjitha lëndët janë parashikuar edhe laboratore, seminare dhe praktika, të cilat variojnë nga 25% deri në 50% të ngarkesës totale të secilës lënde. Programi i studimit ka një fokus të lartë në praktikë dhe kjo reflektohet në lëndët e bazuara në projekte si: Programim i Orientuar në Objekte, Programim në Web, Menaxhim Strategik, Dizajnim i Sistemeve Informatike, Formimi dhe Implementimi i sistemeve inteligjente, etj.</p>

<sup>99</sup> Evidencia nr. 30: Syllabusi i lëndës e-Commerce

<sup>100</sup> Evidencia nr. 91: Vendimi-I-KM-Nr.-41-datë-24.01.2018

<sup>101</sup> Evidencia nr. 40: Silabuset e Lëndëve

<sup>102</sup> Evidencia nr. 30: Syllabusi i lëndës e-Commerce

<sup>103</sup> [https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities\\_list/](https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities_list/)



	<p>përpunimit të dhënavës në sasi të mëdha, etj., të cilat i ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të fortë programuese dhe menaxhue se si dhe një sërë aftësish të nevojshme të buta, nga ndërveprimi profesional deri tek menaxhimi i ekipit dhe komunikimi efektiv. Për çdo lëndë lektorët i nxisin studentët të përfshihen edhe në detyra kursi, projekte, raste studimore, prezantime dhe praktika në kuadër të vlerësimit të lëndës. Gjithashtu, lektorët i nxisin studentët të integrojnë njohuritë e marra në disa lëndë duke i konkretizuar në një projekt të përbashkët<sup>104</sup>.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënësit.	<p>Të gjitha lëndët e ofruara nga programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" si dhe shpërndarja e tyre në vite dhe semestra kontribuojnë në arritjen graduale dhe në rrjeten e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nevojshme nga studentët si dhe në arritjen e objektivave akademike të programit të studimit.</p> <p>Shtrirja e lëndëve në dy semestra, organizimi i tyre në module dhe progresioni nga lëndët më bazike në ato më të avancuara mundëson që studentët në përfundim të programit mësimor të arrijnë objektivat formuese të programit dhe rezultatet e të nxënësit. Për ta ilustruar përmendim lëndët e ndërlidhura e të bashkëorganizuara në module si psh: Hyrje në Kontabilitet (semestri I) dhe Kontabilitet Financiar (semestri II), Kontabilitet Kostoje (semestri V)<sup>105</sup>.</p> <p>Në nenin 11 të rregullores së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike"<sup>106</sup> parashikohet zërthimi i ngarkesës mësimore në kredite dhe orë mësimore në auditor dhe punë individuale.</p> <p>Programi lëndor i çdo lënde përmban informacion të detajuar mbi përkrimin e lëndës, objektivat dhe rezultatet e të nxënësit që synohen të arrihen.<sup>107</sup></p>
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë eshtë në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngashme ndërkombëtare.	<p>Modeli i programit të studimit është i bazuar tek struktura e programeve të studimit bashkëkohore si në IAL publike dhe jopublike brenda vendit ashtu edhe në institucionë të arsimit të lartë në Europë e më gjérë. Nga përvojat analoge të kurrikulave dhe të programeve të studimit në Informatikë Ekonomike të ofruar brenda vendit janë konsultuar dhe adoptuar një qasje krahasimisht e ngjashme me programet e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike-Universiteti i Tiranës, Bachelor Business Informatics -Universiteti European i Tiranës, Bachelor in Economic Informatics Universiteti Metropolitan dhe Bachelor Informatika Ekonomike UAMD si dhe Bachelor në Informatikë Ekonomike University of New York Tirana. Ndërkohë nga rajoni e më gjérë janë konsultuar programet Bachelor in Business Informatics-Southeast European University Maqedoni, Bachelor in Business Informatics-Universiteti i Vienës, dhe Bachelor në Business Informatics University of Manheim Germany. Programi i studimit është hartuar në përputhje me parimet e kartës së Bolonjës dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve<sup>108</sup> duke i dhënë rëndësi të posaçme si aspektit teorik ashtu edhe atij praktik. Profili i programit parashikon një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mes lëndëve të profitit të ekonomisë dhe të informatikës, në përputhje kjo edhe me modelet që janë marrë për bazë.</p> <p>Raporti teori praktikë eshtë në përputhje të plotë me vendimin nr. 824 mbi miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë i cili në standartin 2.4, kriteri 3<sup>109</sup> parashikon: "Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimi në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë eshtë në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngashme ndërkombëtare"<sup>110</sup>.</p>

<sup>104</sup> <https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities/integrated-innovation/2083>

<sup>105</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike

<sup>106</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, nen 11

<sup>107</sup> Evidencia nr. 40: Syllabuset e lëndëve

<sup>108</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/P%C3%ABrmbledhje-e-legislacionit-p%C3%ABr-arsimin-e-lart%C3%ABr-deri-me-11.01.2023-Pdf-2.pdf>

<sup>109</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/27.-vendim-2021-12-24-824.pdf>

<sup>110</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike



<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijet e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Raporti i formimit teorik dhe praktik është i balancuar masën 50% me 50%<sup>111</sup> për të arritur objektivat formuese si dhe për të arritur transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Ndarja në veprimtari formuese, raportet midis formimit teorik dhe praktik dhe përafrimi me modelet kombëtare dhe ndërkombëtare, mundësojnë transferim të studimeve<sup>112</sup><sup>113</sup>, mobilitet të studentëve përmes programeve të tillë si Erasmus +<sup>114</sup>.</p> <p>Lëndët dhe përbajtja e planit mësimor organizohen sipas kategorive A-E me peshën specifike<sup>115</sup> të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Në fillim të çdo semestri, diskutohen arrijet dhe problematikat e hasura në rishikimin e përbajtjes së lëndëve dhe në rishikimin dhe përditësimin dhe pasurimin e literaturës bazë dhe ndihmëse. Këto diskutime marrin vëmendje në mbledhjet e Këshillit të Departamentit të organizuara për këtë qëllim.<sup>116</sup> Nga ana tjetër, në fillim të çdo semestri, pedagogu i lëndës është i detyruar të ngarkojë në Bedër Information System (BIS) programin e lëndës, bashkë me përditësimet e nevojshme, duke përcaktuar qartësisht literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse (botime brenda 5 viteve të fundit)<sup>117</sup>. Programi i lëndës firmoset dhe dorëzohet edhe pranë koordinatorit të departamentit.<sup>118</sup></p>
<b>Kriteri 6.</b> Përbajtja e programit të studimit garanton përfstimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Struktura dhe përbajtja e lëndëve të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira pozitive të disa prej universiteteve më me eksperiençë në fushën e ekonomisë dhe informatikës, që garanton përfstimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p>Programi pajis studentët me dije të larta akademike, kompetencë, aftësi dhe njohuri të aplikuara në fushën e ekonomisë dhe informatikës, analizimit të të dhënavës në mënyrë inteligjente dhe elementeve të sistemeve të informacionit, në mënyrë që të arrijnë përbushje profesionale në tregun e punës kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.<sup>119</sup></p> <p>Në fund të këtij programi studentët do të jenë të aftë të përpunojnë të dhënavë për shërbime në fushën e ekonomisë, të përdorin dhe të përshtaten me të gjitha pajisjet dhe softwarët bashkëkohorë dhe sistemet teknologjike moderne të informacionit, të komunikojnë efektivisht me klientët, të zhvillojnë të menduarit kritik dhe të marrin vendime etike në çdo situatë<sup>120</sup>.</p> <p>Ruatja e raportit teori praktikë, përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënësit, si dhe diversifikimi i vlerësimit përmes disa komponentësh të tillë si punë me projekte, detyra kursi, ese, studime rasti dhe zhvillim projektesh mundëson përfstimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të studentëve.</p> <p>Diversifikimi i vlerësimit parashikohet edhe në nenin 13 të rregullores së programit të studimit<sup>121</sup>: "Procesi i arsimimit përbëhet nga leksionet, projektet dhe puna në studio, punimet në laborator praktikat, seminare, punimi i diplomimit dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor, si dhe cdo element tjetër të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave për elementet që duhet të përbajnjë programet e studimit."</p>

<sup>111</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/27.-vendim-2021-12-24-824.pdf>

<sup>112</sup> Evidencia nr. 41: Rregullorja për transferim të studimeve

<sup>113</sup> Evidencia nr. 103. Vendim i Komisionit AD-HOC për njohjen e krediteve për transferim

<sup>114</sup> Evidencia nr. 104: Shkëmbimi i studenteve

<sup>115</sup> Shtoja: Tabela nr. 9: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)

<sup>116</sup> Evidencia nr. 112: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve

<sup>117</sup> Evidencia nr. 109: Shembull syllabusi të përditësuar

<sup>118</sup> Evidencia nr. 40: Syllabuset e lëndëve

<sup>119</sup> Evidencia nr. 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, pika 1, qëllimi

<sup>120</sup> Evidencia nr. 5: Propozim për hapjen e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, pika 1, objektivat

<sup>121</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike - Neni 13



	Nga ana tjeter, ky strukturim i programit të studimit mundëson nxitjen e aftësive të tilla si: zgjidhja e problemeve, të menduarit kritik, puna e pavarur dhe në grup, aftësitë bashkëpunuese etj. <sup>122</sup>								
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është në përputhje me Nivelin 6 të KShK-së sic përcaktohet në ligjin nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" (KShK) <sup>123</sup> , i ndryshuar dhe mundëson kalimin në nivelet e tjera të KShK apo integrimin në tregun e punës. Përmbajtja e programit parashikon përfitimin e njohurive bazë shkencore dhe profesionale, të cilat mundësojnë thellimin e mëtejshëm të këtyre njohurive në nivelet e tjera të studimeve. Prania në strukturën e programit e lëndëve të tilla me orientim kërkimor si Shkrim Akademik dhe Metoda Kërkimore, mundëson që studentët të pajisen me aftësitë e nevojshme për vijimin e studimeve të thelluara në ciklin e dytë të studimeve. Përfshirja aktive e studentëve në lëndë të tilla me orientim profesional të lidhura ngushtë me tregun e punës, si: kontabilitet, kontabilitet financiar, kontabilitet kostoje, programim Java, Programim në Web, datamining, programim mobile, sisteme operative, etj., mundëson që studentët të integrohen suksesshëm në tregun e punës menjëherë pas përfundimit të studimeve të tyre. <sup>124</sup> Praktika profesionale e detyrueshme është nga lëndët e programit të studimit, e cila realizohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet partnere. <sup>125</sup>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjera nga tregu i punës.	<p>Vlerësimi dhe përmirësimi i programeve të studimit është pjesë e rëndësishme e KU "Bedër" për të siguruar që programet e studimit dhe programi mësimor të plotësojnë nevojat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Në politikat e përmirësimit të programit të studimit, pika 3.3.1<sup>126</sup>, parashikohet: "Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar realizohet në semestrin e fundit me studentët në prag diplomimi".<sup>127</sup> Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga ekspertë të jashtëm ose bashkëpunëtorë të fushës realizohet pas diplomimit të brezit të parë në vazhdim. Propozimet për ndryshime në kurrikulat ekzistuese bëhen nga njësitë bazë, të cilat propozojnë ndryshime apo programe të reja duke kërkuar edhe mendimin e një eksperti të jashtëm për të garantuar cilësi dhe paanshmëri në bëjen e ndryshimeve".</p> <p>Për të realizuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", si dhe për të realizuar sa më mirë pritshmëritë dhe nevojat e tregut të punës, zyra e planifikimit të karrierës në bashkëpunim me këshilltarin e karrierës dhe departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit organizon takime të</p>

<sup>122</sup> Evidenca nr. 40: Syllabuset e lëndëve

<sup>123</sup> [https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/LIGJ-10247-2010\\_komiza\\_shqiptare\\_e\\_kualifikimeve.pdf](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/LIGJ-10247-2010_komiza_shqiptare_e_kualifikimeve.pdf)

<sup>124</sup> Evidenca nr. 29: Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike

<sup>125</sup> Shtypja: Tabela nr. 5: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese

<sup>126</sup> Evidenca nr. 46: Politika për Përmirësimin e programeve të studimit, pika 3.3.1

<sup>127</sup> Evidenca nr. 47: Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit

<sup>128</sup> Evidenca nr. 4: Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit



<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	studentëve me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës. <sup>129, 130</sup> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Në mbledhjet e Këshillit të Departamentit marrin pjesë përfaqësues të studentëve. Studentët përcjellin mendimin dhe vlerësimin e grupit mbi programin dhe lëndët specifike. <sup>131</sup> Gjithashtu, pjesëmarrja aktive në plotësimin e anketës që realizohet për çdo lëndë <sup>132</sup> në përfundim të semestrit është një nga mënyrat sesi studentët ndikojnë në përmirësimin e programit. Në Statutin e KU "Bedër" <sup>133</sup> specifikohet përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, sipas të cilit studentët janë të përfshirë në Senat Akademik (neni 10) dhe NJSBC (neni 28). Po ashtu, studentët janë të përfshirë edhe në Komisionin e Përherëshëm të Garantimit të Cilësisë <sup>134, 135</sup> dhe në Këshillin e Departamentit <sup>136</sup> .								
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Për të realizuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit si njësia përgjegjëse e programit përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh si dhe institucione publike e private në fushën e ekonomisë si dhe në sistemet informatike. Në takimet e njësisë përgjegjëse, me qëllim përditësimin e përmbajtjes, objektivave formuese, rezultateve të të nxenit, literaturës dhe vlerësimit të syllabuseve të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", janë ftuar të marrin pjesë dhe të jalin mendimet e tyre edhe lektorë të ftuar, profesionistë të fushës, apo përfaqësues të institucioneve partnere <sup>137</sup> .								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<sup>129</sup> Evidencia nr. 61 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Këshillit.

<sup>130</sup> [https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities\\_list/](https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities_list/)

<sup>131</sup> Evidencia nr. 71: Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit

<sup>132</sup> Evidencia nr. 34: Anketa e studentit ndaj lëndës

<sup>133</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i Kolegit Universitar Bedër, neni 10, 28

<sup>134</sup> Evidencia nr.16: Rregullorja e funksionimit të komisionit të përherëshëm për garantimin e standardeve të cilësisë internacionale të programeve të studimit, neni 10.

<sup>135</sup> Evidencia nr. 97: Vendimi për emerimin e Antarëve të Komisionit të Përherëshëm të Garantimit të Standardeve dhë Cilësise

<sup>136</sup> Evidencia nr.71: Studentët Përfaqësues në Mbledhjet e Këshillit të Departamentit

<sup>137</sup> Evidencia nr. 112: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njoburive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>KU "Beder" aplikon si forma të zakonshme të mësimdhënies, leksionet, seminaret, punët e laboratorit, detyrat e kursit, projektet, raste studimore, esetë, praktikat profesionale, etj. Format e mësimdhënies janë të parashikuara si në Rregulloren Themelore (neni 78, pika 3)<sup>138</sup>, ashtu edhe në Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve (neni 11)<sup>139</sup>.</p> <p>Në zbatim të parashikimeve të mësipërme, në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (neni 13) specifikon: "<i>Procesi i arsimimit përbëhet nga leksionet, projektet dhe puna në studio, punimet në laborator praktikat, seminare, punimi i diplomimit dhe punime të tjera të ngashme, të parashikuara në programin mësimor, si dhe çdo element tjetër të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave për elementet që duhet të përbajnë programet e studimit</i>".<sup>140</sup> <sup>141</sup></p> <p>Praktika profesionale parashikohet të zhvillohet gjatë programit mësimor dhe është lëndë e detyrueshme me 4 ECTS në semestrin e gjashtë.<sup>142</sup></p> <p>Përveç aktivitetit mësimor bazë, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit organizon në mënyrë periodike leksione të hapura me ekspertë të fushës, si dhe workshop-e ku studentët ndërveprojnë dhe zhvillojnë më tej aftësitë e tyre analitike, tashmë një traditë e institucionit prej vitesh. Këto leksione të hapura të organizuara shpeshherë në formën e worshkshop-eve dhe seminarve apo trajnimeve me profesionistë të fushës, janë pjesë e planeve të aktiviteteve të njësisë bazë dhe miratohen nga e gjithë hierarkia e organeve përkatëse.<sup>143</sup> Aktivitetet publikohen në website-in zyrtar të institucionit/departamentit dhe pasqyrohen në raportet vjetore të departamentit.<sup>144</sup></p>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	<p>Personeli akademik respekton dhe u jep përgjigje larmisë dhe nevojave të studentëve. Së pari, përditësimi i përvitshëm i syllabuseve,<sup>145</sup> nisur nga nevojat e ndryshme dhe diversiteti i studentëve është pasqyrim i kombinimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të studentëve me aftësi njoħe të ndryshme, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës, për auditore heterogjene dhe multikulturore. Në këtë kuadër institucioni ka hartuar një Politikë për mësimdhënien innovative.<sup>146</sup> Procesi i vlerësimit e anketimit të syllabuseve nga ana e studentëve në përfundim të çdo semestri dhe analizimi i gjetjeve janë një mënyrë orientimi dhe përditësimi mbi nevojat e studentëve.<sup>147</sup> Përfaqësues të studentëve janë pjesë e mbledhjeve periodike të Këshillit të Departamentit duke përcjellë zérin, propozimet, ankesat, sugjerimet e studentëve për shqyrtim në Këshillin e Departamentit.<sup>148</sup></p> <p>Në përgjigje të nevojave të studentëve realizohen orë shtesë dhe konsulta me pedagogët përkatës, në varësi të nevojës dhe kërkesave. Komunikimi i vazhdueshëm mes studentëve dhe stafit akademik shtrihet dhe në komunikimin elektronik, hedhjen e materialeve dhe vlerësimeve në google classroom, shpërndarjen në drive, etj.</p>

<sup>138</sup> Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore - Neni 78 pika 3.

<sup>139</sup> Evidenca nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë - Neni 11.

<sup>140</sup> Evidenca nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike - Neni 13

<sup>141</sup> Evidenca nr. 30: Syllabusi i lëndës e-Commerce

<sup>142</sup> Evidenca nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike - Neni 16.

<sup>143</sup> Evidenca nr. 70: Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2023-2024.

<sup>144</sup> Evidenca nr. 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023

<sup>145</sup> Evidenca nr.112: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve

<sup>146</sup> Evidenca 102. Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU Beder

Evidenca nr. 34: Anketa e studentit ndaj lëndës.

<sup>148</sup> Evidenca nr. 71: Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit.



<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësit.	<p>KU "Bedër" kujdeset të ofrojë trajnime vjetore për personelin akademik, në funksion të përmirësimit të kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësit si dhe, fusha të tjera të nevojshme për rritjen profesionale të stafit.<sup>149</sup> Në formularin periodik për vetëvlerësimin e stafit akademik parashikohen objektivat për vitin pasardhës dhe planet për trajnime të personelit, të cilat plotësohen nga secili anëtar në seksionin B pika b.<sup>150</sup> Është praktikë që çdo fillim viti të organizohen trajnime profesionale me fokus përmirësimin e mësimdhënieve, integrimin e teknologjisë në mësimdhënie apo ndërthurjen e kërkimit shkencor me mësimdhëni si dhe trajnime me në fokus diversifikimin e formave të mësimdhënieve dhe mësimnxënies dhe avancimin e aftësive didaktike të lektorëve.<sup>151 152</sup> Ndërsa trajnime të organizuara me tematika në këtë fokus në fillim të vittit akademik mund të listojmë: "Teknologja në ndihmë të mësimdhënieve cilësore në universitet", si dhe "Përditësimi i syllabuseve si nevojë në vijueshmëri". Në të njëjtën linjë, programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" merr në konsideratë dinamikat e zhvillimeve të fundit teknologjike dhe natyrën e studimeve që ofron, por dhe kërkesat në rritje të gjeneratës së re të studentëve, lidhur me inkluadrin e programeve <i>softwerike</i> në procesin e mësimdhënieve. Nga ana tjetër, një ndër qëllimet e leksioneve të hapura dhe workshopave të organizuara me përfaqësues të industrive të ndryshme është që të diskutohet mbi dinamikat dhe kërkesat e tregut të punës, duke kuptuar pritshmëritë me qëllim reflektimin e tyre në metodologjitë e mësimdhënieve.<sup>153 154</sup> Paralelisht, KU "Bedër" i kushton rëndësi ofrimit të një infrastrukturë mbështetëse për ofrimin e shërbimit sipas kërkesave dhe metodologjive moderne.<sup>155</sup></p>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhëni në program është kompet përdor metoda të ndryshme të mësimdhënieve interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p>Ndërsa objektivat strategjik të KU "Bedër" është tërheqja e një stafi të kualifikuar, me grada e tituj shkencorë dhe në përputhje me synimet dhe standarde përcaktuara në Planin Strategjik të Institutacionit (kapitulli III, pika A).<sup>156</sup> KU "Bedër" përmes rregullores së punësimit, në nenin 5, pika 6, përcakton kushtet e punësimit dhe vlerësimit që duhet të përbushë personeli akademik, i angazhuar në mësimdhëni në programet e studimit. Në mënyrë që stafi i angazhuar të jetë kompetent në përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënieve, specifikon se "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës".<sup>157</sup> Për të garantuar që personeli akademik i angazhuar është në nivel me pritshmëritë dhe kërkesat e institucionit, si dhe të ketë ekspertizën dhe kompetencat e duhura në ndërtimin e procesit të mësimdhënieve me metoda bashkëkohore në përputhje me kurrikulat, rekrutimi i tyre kalon nëpërmjet një procesi vlerësimi dhe verifikimi nga drejtuesit e institucionit në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit.<sup>158</sup> Nga dosja e CV-ve të stafit vihet re se anëtarët e personelit akademik kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të plotësuar objektivat e programit, janë profesionistë të fushës të angazhuar si në institucione shtetërore, ashtu edhe në sektorin privat apo <i>freelance</i> (punë e pavarur) të licencuar për të marrë përsipër detyra të lidhura</p>

<sup>149</sup> Evidencia nr. 69: Lista e Trajnimeve të organizuara për Stafin Akademik 2014-2022.

<sup>150</sup> Evidencia nr. 39: Formular vlerësimi për stafin akademik.

<sup>151</sup> Evidencia nr.100: Program seminaresh dhe trajnimesh.

<sup>152</sup> Evidencia nr.101: Lista e Trajnimeve me qellim permiresimin e aftësive didaktike

<sup>153</sup> Evidencia nr. 70: Plani i aktiviteteve për vitin akademik 2023-2024.

<sup>154</sup> Evidencia nr. 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023.

<sup>155</sup> Shtoja: Tabela nr. 16: Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit.

<sup>156</sup> Evidencia nr. 15, Plani Strategjik institucional, kapitulli III, pika A

<sup>157</sup> Evidencia nr. 44: Rregullore për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik, nen 5, pika 6.

<sup>158</sup> Evidencia nr. 23 Procedura e rekrutimit të stafit akademik.



	<p>ngushtësisht me fushën e ekonomisë dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.<sup>159</sup></p> <p>Me qëllim orientimin e lektorëve me eksperiencë apo atyre rishtarë, në integrimin e metodave inovative në mësimdhënie dhe në një përfshirje më aktive të studentëve përmes formave të ndryshme të mësimnxënies, KU "Bedër" ka hartuar një udhëzues mbi mësimdhëni inovative i cili përfshin "udhëzime në lidhje me vijueshmérinë e mësimit, realizimin e programeve të kurseve përkatëse, metodat e mësimdhëni inovative, si dhe me procedurat e vlerësimit të studentëve në funksion të përbushjes së detyrimeve akademike dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie. Ky udhëzues synon gjithashtu të ndihmojmë studentët e Kolegit Universitar Bedër të jenë më të motivuar dhe më të angazhuar gjatë procesit të mësimnxënies. Manuali ndjek qasjen e mësimdhëni me qendër studentin".<sup>160</sup></p> <p>Lektorët sigurohen që format e aktivizimit të studentëve gjatë procesit mësimor të janë të shumëllojshme duke përfshirë detyrat e kurseve dhe projektet me tematika dhe natyra të ndryshme në varësi edhe të lëndëve. Aktivizimi i tyre bëhet përmes projekteve individuale dhe në grup dhe finalizohet me një prezantim të punës së tyre në fund të semestrit. Në mënyrë të tillë, studentët inkurajohen të punojnë në mënyrë analitike, të bëjnë vlerësim kritik të situatave të ndryshme, të aftësohen me punën në mënyrë të pavarur dhe në grup, të dinë të delegojnë dhe të mbajnë përgjegjesi, të zhvillojnë aftësitë komunikuese e prezantuese dhe aftësitë e tjera të buta.<sup>161</sup></p> <p>Lektorët këshillojnë, orientojnë dhe mbështesin studentët gjatë gjithë procesit të mësimdhëni si dhe atij të përgatitjes për diplomim përmes konsultimeve individuale të herëpashershme me kërkesë të studentëve apo konsultimeve në grup. Në funksion të mbështjetes së vazdueshme stafi vë në dispozicion orët e konsultave për studentët. Guida e stafit<sup>162</sup> rregullon marrëdhëniet student-lektor dhe sigurohet që këto marrëdhënie të janë etike dhe të shëndosha. Gjithashtu, këshilltari akademik.<sup>163</sup> si një strukturë e posaçme, mbështetëse për studentët, ndjek nga afër gjithë procesin e mësimnxënies.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhëni në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektoj mendimet e këshillat e tyre.	<p>KU "Bedër" ka përfshirë në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhëni studentët nëpërmjet anketimit dhe vlerësimit periodik. Vlerësimi dhe përmirësimi i procesit të mësimdhëni realizohet nga institucioni nëpërmjet një procesi të mirëstrukturuar ku përfshihet dhe angazhimi i studentëve nëpërmjet anketës së vlerësimit të pedagogut të lëndës.<sup>164</sup></p> <p>Studentët plotësojnë anketën në fjalë në fund të çdo semestri, që përkon me periudhën përpëra provimit përfundimtar. Kjo mënyrë vlerësimi, është një mjet mjaft i rëndësishëm nëpërmjet të cilit institucioni garanton dhe përmirëson cilësinë e mësimdhëni në mënyrë periodike. Anketa në përbërje ka pyetje të mbyllura ku studentët kanë vetëm disa alternativa për zgjedhjen e përgjigjes, si dhe në fund iu është lënë hapësira për të shtuar komente lidhur me çështjen në fjalë dhe vlerësimin e pedagogut. Pikit e pyetësorit mbi të cilat pyeten studentët janë: (i) përpikmëria e pedagogëve; (ii) përgatitja e lëndës; (iii) zotërimi njohurive të lëndës; (iv) literatura dhe materialet shtesë të lëndës; (v) ndërveprimi me studentët; (vi) metodat e mësimdhëni dhe vlerësimi i performancës së studentëve dhe menaxhimi i kohës.</p> <p>Në javën e parë të çdo semestri pedagogët ofrojnë mundësi për studentët që të diskutojnë dhe vlerësojnë mënyrat dhe metodat e mësimdhëni të lëndës përkatëse, në mënyrë të tillë të vendosin për vijueshmérinë e mëtejshme të procesit me mëmor të lëndës përkatëse.</p>

<sup>159</sup> Evidencia nr. 54: CV-të e stafit akademik

<sup>160</sup> Evidencia nr. 102: Udhëzues mbi mësimdhëni inovative në KU "Bedër"

<sup>161</sup> Evidencia nr. 30: Syllabus i lëndës e-Commerce

<sup>162</sup> Evidencia nr. 27: Guida e Stafit.

<sup>163</sup> Evidencia nr. 42: Miratimi i Udhëzuesit të Këshilltarit Akademik

<sup>164</sup> Evidencia nr. 34: Anketa e Studentit ndaj lëndës.



	<p>Përfshtirja e studentëve në mbledhjet e njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe përfshirja e tyre si detyrim ligjor në organet kolegiale të KU "Bedër" është parashikuar edhe në vendimmarjet e këtyre organeve. Gjithashtu, studentët marrin pjesë vazhdimisht në mbledhjet e këshillit të departamentit ku diskutohen çështje me interes të përbashkët mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor në terësi.<sup>165</sup></p> <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitet kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitat përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> <p>Përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies në nivel institucional, organizohet dhe drejtohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.<sup>166</sup> Institucioni, gjithashtu, ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit<sup>167</sup> i cili është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Krahas këtyre strukturave institucionale, njësia bazë që garanton dhe është përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit në KU "Bedër". Sigurimi i cilësisë është i harmonizuar mes NJSBC, njësive bazë dhe zyrës së burimeve njerëzore, ku në bazë të propozimeve dhe sugjerimeve të ardhura nga njësitet bazë, koordinohet puna nga ana e zyrës së burimeve njerëzore, për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie duke përgatitur planin e trajnimeve të stafit.<sup>168</sup> Rregullorja e NJSBC-së përcakton mënyrën e organizimit dhe detyrat që kanë njësitet kryesore dhe bazë në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.<sup>169, 170, 171</sup></p> <p>Njësitet që kryejnë trajnime të rregulla për zhvillimin profesional të personelit akademik janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve, Zyra e Burimeve Njerëzore, Fakultete përkatëse si dhe të gjithë anëtarët e tjera bazuar në nevojat dhe Strategjinë Institucionale dhe Planin e Veprimit.<sup>172</sup> Raste konkrete të mënyrës së organizimit të trajnimeve nga njësi të ndryshme ose disa njësi të koordinuara mund të përmendim: trajnimet organizuar nga NJSBC<sup>173</sup>; NJSBC në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion<sup>174</sup>; trajnim i organizuar nga Zyra e Projekteve në bashkërendim me Zyrën e Burimeve Njerëzore; gjithashtu, marrëveshja e bashkëpunimit me <i>Educators without Borders</i> ka mundësuar realizimin e një sërë trajnimesh për një pjesë të stafit akademik.<sup>175</sup></p> <p>Një komponent i rëndësishëm që i vjen në ndihmë institucionit por edhe njësissë bazë, si mjet vlerësues i përformancës dhe si bazë analitike për përmirësimin e përformancës akademike e shkencore, është formulari i vetëvlerësimit që plotësohet çdo vit nga stafi akademik.<sup>176</sup> Vlerësimi i stafit akademik bëhet në bazë të gjashtë pikave kryesore, të cilat janë: kërkimi shkencor; mësimdhënia, e cila vlerësohet në bazë të lëndës, programit të studimit dhe semestrit; kontributi në jetën universitare i personelit akademik; shërbimi publik që ka kryer; aktivitetet akademike; aktivitetet profesionale.<sup>177</sup> Raporti i vetëvlerësimit u përcillet më tej njësive kryesore dhe</p>
--	---

<sup>165</sup> Evidencia nr. 71: Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit

<sup>166</sup> Evidencia nr. 17: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së.

<sup>167</sup> Evidencia nr. 16: Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.

<sup>168</sup> Evidencia nr. 69: Lista e Trajnimeve të organizuara për Stafin Akademik 2014-2022

<sup>169</sup> Evidencia nr. 17: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së - Neni 10.

<sup>170</sup> Evidencia nr. 39: Formular vlerësimi për stafin akademik.

<sup>171</sup> Evidencia nr. 47: Anketë vlerësimi e studentëve për programin e studimit.

<sup>172</sup> Evidencia nr. 69: Lista e Trajnimeve të organizuara për Stafin Akademik 2014-2022.

<sup>173</sup> <http://qac.beder.edu.al/>

<sup>174</sup> <https://csdi.beder.edu.al/>

<sup>175</sup> Evidencia nr. 88: Marrëveshje me Education without Borders.

<sup>176</sup> Evidencia nr. 39: Formular vlerësimi për stafin akademik.

<sup>177</sup> Evidencia nr. 49: Procedura e vlerësimit të përformancës së stafit akademik



	finalizohet nga Komisioni i Përhershëm i Kërkimit Shkencor, Projekteve, Aplikimit dhe Inovacionit. <sup>178</sup> Në përbushje të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave KU "Beder" ka hartuar udhëzuesin në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. <sup>179</sup> Ky udhëzues përmban informacion mbi mësimdhënien, mënyrat, qasjet dhe metodat inovative të mësimdhënies në arsimin e lartë, format e organizimit të vlerësimit, si dhe metodologjitet e përdorura për mësimdhënie dhe të nxënë gjithëpërfshirës në KU "Beder".			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b> <b>X</b>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<i>Rregullorja Themelore e KU "Beder"<sup>180</sup> Kreu 12 "Për mënyrën e vlerësimit të Notave, Provimeve dhe Kalueshmërise"; Kreu 13 për "Praktikat profesionale", <i>Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë</i>, neni 16, neni 22 dhe neni 23<sup>181</sup>; <i>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike"</i>,<sup>182</sup> neni 20 dhe neni 27, dhe <i>Udhëzuesi mbi mësimdhënien Inovative</i><sup>183</sup> (vlerësimi), përcaktojnë format e ndryshme të vlerësimit që mund të aplikohen nga lektorët në se cilën lëndë. KU "Beder" i pajis studentët me Guidën e Studentit<sup>184</sup> e cila informon studentët për të gjithë rregullat, proceset, politikat dhe procedurat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen zyrtare të KU "Beder".<sup>185</sup> Në të njëjtën linjë dhe në përputhje me dokumentet bazë, informacionet kryesore që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e studentit, bëhen të ditura dhe përfshihen në kontratën që studenti nënshkruan gjatë procesit të regjistrimit.<sup>186</sup> Institucioni paraqet në mënyrë të detaujar kriteret për vlerësimin e notës përfundimtare në Guidën e Stafit si dhe në Guidën e Studentit në KU "Beder".<sup>187 188</sup> Pas regjistrimit në Universitet, studentët pajisen me llogari email të institucionit nga Sekretaria Mësimore përmes së cilës mund të aksesojnë llogarinë e tyre në "Beder Information System" (BIS). Në këtë platformë studentët janë të përditësuar mbi pikët e marra në vlerësim, mungesat si dhe përbajtjet e lëndëve të zhvilluara. Gjithashtu, institucioni organizon seanca dhe takime informuese për studentët e regjistruar në javën e parë mësimore lidhur me politikat dhe proceset që rregullojnë studimet e tyre. Brenda javës së parë, pedagogu i lëndës pasqyron në syllabus-in e lëndës përkatëse format e ndryshme të vlerësimit të përfaqësuarame përqindjet</i>

<sup>178</sup> Evidencia nr. 19: Rregullorja mbi projekte kërkimore shkencore.

<sup>179</sup> Evidencia nr. 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në Kolegjin Universitar "Beder"

<sup>180</sup> Evidencia nr. 3: Rregullorja Themelore, kreu 12 dhe 13

<sup>181</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 16, 22 dhe 23.

<sup>182</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.

<sup>183</sup> Evidencia nr. 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU "Beder"

<sup>184</sup> Evidencia nr. 28: Guida e Studentit.

<sup>185</sup> [https://beder.edu.al/static/docs/guida\\_e\\_studentit\\_shqip\\_17\\_4710.pdf](https://beder.edu.al/static/docs/guida_e_studentit_shqip_17_4710.pdf).

<sup>186</sup> Evidencia nr. 72: Kontrate Studimi Bachelor.

<sup>187</sup> Evidencia nr. 27: Guida e Stafit - Kapitulli 21, 22.

<sup>188</sup> Evidencia nr. 28: Guida e Studentit - Kapitulli 19, 20



	përkatëse <sup>189</sup> dhe informon studentët mbi kriteret e vlerësimit të notës përfundimtare referuar Rregullores për Programet e Studimit të Ciklit të Parë. <sup>190</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në javën e parë të fillimit të semestrit, lektorët e lëndës informojnë studentët mbi kriteret e vlerësimit, objektivat e lëndës, materialet e detyruara dhe të sugjeruara për lexim, për temat e trajtuara në secilën javë dhe mbi rezultatet e procesit të të nxenit. Gjithashtu, pedagogu i lëndës plotëson dhe publikon syllabusin e lëndës, të cilin studentët mund ta aksesojnë në platformën e sistemit të informacionit (BIS) të KU "Bedër". <sup>191</sup> Në këtë mënyrë studentët mund të kenë akses mbi të gjitha lëndët e regjistruara për të kontrolluar përbajtjen e programeve mësimore, strukturën kalendarike të organizimit të secilës lëndë si dhe shpërndarjen e vlerësimit. <sup>192</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme bazuar tek VKM nr. 41 i datës 24.01.2018 <sup>193</sup> duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njojuritë dhe kompetencat e fituara. Këto forma të ndryshme të testimit të njojurive janë të parashikuara tek Rregullorja Themelore (neni 100, Forma e provimit) <sup>194</sup> , Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë (neni 19) <sup>195</sup> ku shprehet se nota kaluese në një lëndë, përcaktohet nga punimet përkatëse të kryera gjatë atij semestrit (provimet gjatë semestrit, provimet gysmë-finale, kuize, aplikimet, detyrat, projektet, ateljet, seminaret, pjesëmarrja, laboratori etj), së bashku me notën e marrë në provimin përfundimtar. Forma e vlerësimit përfshihet edhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", (neni 27) <sup>196</sup> . Në udhëzuesin për mësimdhënien innovative <sup>197</sup> detajohen më tej format e vlerësimit duke përfshirë vlerësimin formues, përbledhës dhe normativ. Në të njëjtën mënyrë testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive shpjegohen tek Guida e Stafit <sup>198</sup> dhe Guida e Studentit <sup>199</sup> të KU "Bedër". Për të ilustruar se si nota përfundimtare e një lënde përfshin të gjitha detyrat me të cilat është ngarkuar një student dhe që është vënë në dijeni nga lektori i lëndës përkatëse mund t'i referoheni Shtojcave, tabela nr.15 <sup>200</sup> dhe një shembull syllabusi <sup>201</sup> . Në mënyrë praktike, komponentët e vlerësimit përfshijnë: testime, projekte konkrete, detyra kursi, kuize, punë në grup, raste studimore, analiza, prezantime, aplikime në raste konkrete reale në bashkëpunim me biznese ose agjenci që operojnë në treg. Duke diversifikuar mënyrën e vlerësimit dhe duke treguar kujdes në përfshirjen e një numri të balancuar komponentësh vlerësues, arrihet të maten më mirë njojuritë e marra dhe kompetencat e zotëruara gjatë lëndës.	
<b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke	Hartimi i politikave të vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies ndërmerret në nivel institucional nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe organizimi shtrihet gjithashtu edhe në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë të cilat ndërveprojnë me njërat-tjetërën për të koordinuar punën dhe siguruar cilësinë në nivelin e kërkuar nga njësitë përkatëse. NJSBC-ja harton rregulloren <sup>202</sup> që

<sup>189</sup> Evidencia nr. 30: Syllabusi i lëndës e-Commerce

<sup>190</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

<sup>191</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).

<sup>192</sup> Evidencia nr. 110: Screenshot i Sistemit BIS

<sup>193</sup> Evidencia nr. 91: VKM nr. 41 i datës 24.01.2018

<sup>194</sup> Evidencia nr. 3: Rregullore Themelore, nenı 100, Forma e provimit

<sup>195</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, nenı 19.

<sup>196</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, nenı 27

<sup>197</sup> Evidencia nr. 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU "Bedër", Vlerësimi.

<sup>198</sup> Evidencia nr. 27: Guida e Stafit

<sup>199</sup> Evidencia nr. 28: Guiden e Studentit

<sup>200</sup> Shtojca: Tabela nr. 15: Format e kontrollit të njojurive

<sup>201</sup> Evidencia nr. 30: Syllabusi i lëndës e-Commerce.

<sup>202</sup> Evidencia nr. 17: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së



reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	duhet të ndiqet në nivel institucional dhe përcakton qartë detyrat që kanë njësitetë në rang fakulteti dhe departamenti. Ndër të tjera në këtë rregullore theksohet pjesmarrja e studentëve në anketimin periodik <sup>203</sup> për vlerësimin e titullarit të lëndës, shërben si një pikënisje për adresimin e çështjeve me interes prioritar për sa i përket sigurimit të qëndrueshëm të cilësisë në Universitet. Ndërkohë, njësia bazë ju jep mundësinë studentëve të përfshihen në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të formave e metodave të mësimdhënies duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre përmes anketës në përfundim të lëndës ku ndër të tjera pyeten për metodat e format e mësimdhënies të përdorura gjatë semestrit. <sup>204</sup> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre të ardhura nga studentët përfaqësues në mbledhjet e këshillit të departamentit. <sup>205</sup> Në këto mbledhje studentët ftohen të japid mendime mbi metodoligjitë e mësimdhënies të përdorura në klasë nga lektorët si dhe diversifikimin e vlerësimit të lëndëve.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritëshme të të nxënët, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Institucioni në bashkëpunim me personelin akademik hartojnë dhe monitorojnë në vazhdimësi format/praktikat më moderne të mësimdhënies në përputhje dhe me kërkesat e gjeneratës së re të studentëve, por edhe me pritshmëritë e punëdhënësve. Në përputhje me rezultatet e pritëshme të të nxënët, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, institucioni iu vë në dispozicion stafit akademik Udhëzuesin mbi mësimdhënien inovative <sup>206</sup> i cili parashikon metoda të shumëllojshme dhe fleksibël të mësimdhënies që përdoren për të ndihmuar studentët të arrijnë rezultatet e të nxënët. Metodat e mësimdhënies i ndihmojnë studentët të: zotërojnë përbajtjen e lëndës dhe të mësojnë se si të aplikojnë përbajtjen në kontekste të veçanta. Disa nga forma të mësimdhënies janë: leksionet, leksione ndërvepruese, diskutime, mësimdhënie e drejtpërdrejtë, mësimdhënie e udhëzuar, mësimdhënie e përshtatur, të mësuarit bazuar në përvojë, të mësuarit bazuar në raste, të mësuarit bazuar në hulumtim, të mësuarit e bazuar në zgjidhjen e problemeve, të mësuarit e bazuar në projekte, dhe puna në terren. Në udhëzues parashikohen edhe disa nga qasjet për një mësimdhënie inovatore për t'u adoptuar në arsimin e lartë duke përfshirë: <i>Qasja e të menduarit bazuar në Dizajn, Të nxënët e bazuar në një projekt krijues, si dhe Të mësuarit e bazuar në projekte.</i> Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ndërthur një kombinim të mësimdhënies midis qasjes teorike dhe asaj praktike për studentët përgjatë ciklit tre vjeçar të studimit, ku përmes literaturës së rekomanduar, përfshirjes aktive të studentëve me mbikëqyrje të vazhdueshme nga ana e lektorëve nxitet sensi i të nxënët në mënyrë autonome i studentëve. Përpos qasjes teorike, program i studimit ofron lëndë të cilat zhvillohen me metoda praktike për formimin e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Studentët zhvillojnë njohuritë e tyre në programim dhe ekonomi duke punuar me programe softuerike si Python, C++, Java, Eviews 10, Excel etj. <sup>207, 208</sup> Kjo qasje e afron më tepër studentin me pritshmëritë e tregut të punës si dhe ofron fleksibilitet me zbatimin praktik të njohurive të marra nga literatura baze e rekomanduar nga lektori i lëndës. Gjithashtu, për të kultivuar bashkëpunimin mënyrë studentëve, detyrat e kursit dhe projektet vlerësojnë jo vetëm punën individuale të studentëve por edhe aftësitë e tyre të komunikimit dhe bashkëpunimit në grup duke

<sup>203</sup> Evidencia nr.32: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve

<sup>204</sup> Evidencia nr. 34: Anketa e studentit ndaj lëndës

<sup>205</sup> Evidencia nr. 71: Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit

<sup>206</sup> Evidencia nr. 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative në KU "Bedër"

<sup>207</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor ne Informatike Ekonomike

<sup>208</sup> Evidencia nr. 30: Syllabusi i lëndës e-Commerce



	nxitur shkëmbimin e përvojave me njëri-tjetrin si dhe zhvillimin e aftësive të të folurit në publik. <sup>209, 210</sup>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

**Standardi III.3**

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit <sup>211</sup> . Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet duke u bazuar në më shumë se një komponent në përputhje me Vendimi VKM 41 me date 24.01.2018. <sup>212</sup> Vlerësimi përgjatë gjithë semestrit apo vitit akademik, parashikohet të shpërndahet në vlerësim gjysëm final dhe provim përfundimtar. Format e ndryshme të vlerësimit parashikohen në Rregulloren Themelore (neni 100), <sup>213</sup> Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve (neni 23) <sup>214</sup> dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (neni 26) <sup>215</sup> . Për të siguruar transparencën e procesit në lidhje me përiudhën e zhvillimi të provimeve gjysëm finale dhe finale, institucioni bën publik në faqen e tij zyrtare kalendarin akademik. <sup>216</sup>	Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit <sup>211</sup> . Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet duke u bazuar në më shumë se një komponent në përputhje me Vendimi VKM 41 me date 24.01.2018. <sup>212</sup> Vlerësimi përgjatë gjithë semestrit apo vitit akademik, parashikohet të shpërndahet në vlerësim gjysëm final dhe provim përfundimtar. Format e ndryshme të vlerësimit parashikohen në Rregulloren Themelore (neni 100), <sup>213</sup> Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve (neni 23) <sup>214</sup> dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (neni 26) <sup>215</sup> . Për të siguruar transparencën e procesit në lidhje me përiudhën e zhvillimi të provimeve gjysëm finale dhe finale, institucioni bën publik në faqen e tij zyrtare kalendarin akademik. <sup>216</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmanqin formata ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Formati i provimeve në KU "Bedër" është përmes kopjeve fizike, të cilat zhvillohen në auditor, por studenti testohet edhe nëpërmjet formave të tjera të vlerësimit si projekte të cilat mund t'i dorëzojë në kopje elektronike dhe fizike. Notat për të gjitha mënyrat e vlerësimit hidhen në Sistemin Informativ Bedër (BIS), të cilat janë të aksueshme në kohë reale. Nëpërmjet sistemit (BIS) studentët aksesojnë profilet e tyre, listëprezencën, notat për secilin element të vlerësimit si dhe përbajtjen e lëndëve. <sup>218</sup> Kjo formë vlerësimi siguron transparencë për të gjitha palët e interesit si dhe ofron garanci për shmanqien e formave të ndryshme të ndërhyrjes, ndryshimet apo tjetërsimeve dhe abuzimeve të mundshme.

<sup>209</sup> Evidencia nr. 28: Guida e Studentit.

<sup>210</sup> <https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities/integrated-innovation/2083>

<sup>211</sup> Evidencia nr.30: Shembull Syllabusi

<sup>212</sup> Evidencia nr.91: Vendimi VKM 41 me date 24.01.2018

<sup>213</sup> Evidencia nr. 3: Rregullorja Themelore, neni 100

<sup>214</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë të Studimeve, neni 23

<sup>215</sup> Evidencia nr. 35: Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", neni 26

<sup>216</sup> [Kolegji Universitar Bedër - Kalendar Akademik 2023-2024 \(beder.edu.al\)](#)

<sup>217</sup> Evidencia nr. 30: Shembull Syllabusi.

<sup>218</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).



	<p>Në varësi të lëndëve, një formë tjetër testimi e përdorur është testimi elektronik me qëllim rritjen e transparencës duke përdorur platformën "Testportal", një platformë online dhe inovative. Kjo platformë të lejon të krijosh sete pyetjesh së bashku me përgjigjen e saktë dhe të konfigurosh mënyrat se si këto pyetje do ti shfaqen studentëve. Gjatë zhvillimit të testimit studentë të ndryshëm kanë pyetje të ndryshme. Nëse studentët largohen nga provimi paralajmërohen për bllokim testimi. Në përfundim të testimit studentëve i shfaqet rezultati në mënyrë automatike duke shmangur kështu dhe forma të ndryshme abuzimi.<sup>219</sup></p> <p>Një tjetër formë e testimit elektronik është dhe Google Forms, ku testi realizohet në formë të tillë që vlerësimi të bëhet në mënyrë automatike dhe secili student të marrë në mënyrë individuale tezën dhe vlerësimin e tij.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Vlerësimi përfundimtar i njojurive të lëndës bëhet në përputhje me syllabusin i cili hartoheret në përputhje me bazën ligjore në fuqi (VKM Nr. 41).<sup>220</sup> Sikurse është shpjeguar edhe me lart, vlerësimi përfundimtar është i përbërë nga më shumë se një komponent dhe llogaritet si një mesatare e ponderuar e tyre. Pedagogu i lëndës në fillim të semestrit, në bashkëbisedim me studentët, vendos për komponentët e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha që i jepet secilit prej tyre. Në syllabusin e lëndës reflektohen komponentët dhe mënyra e arritjes së vlerësimit përfundimtar.<sup>221</sup></p>
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Transparenca në KU "Bedër" është një nga parimet themelore mbi të cilat ngrihet institucioni dhe ky parim ndiqet në të gjitha format e vlerësimit të njojurive. Lektorët e angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofrojnë konsulencë dhe këshillim të vazhdueshëm edhe jashtë orarit mësimor për studentët e këtij programi studimi. Gjithashtu, udhëzime dhe feedback i detajuar jepet për realizimin e detyrave të kursit, projekteve dhe komponentëve të tjerë të vlerësimit të vazduar.<sup>222</sup></p> <p>Mbarëvartja e provimeve është një proces i mirë organizuar nga njësia përgjegjëse<sup>223</sup>. Që në momentin e hartimit të tezave, njëkohësisht përgatitet nga ana e pedagogëve edhe çelësi i zgjidhjeve që u vendoset në dispozicion studentëve për të bërë transparent vlerësimin e bërë, në rastet kur ka pretendime nga ana e studentëve.<sup>224</sup> Në çdo tezë është i paraqitur qartësisht pikëzimi dhe vlerësimi i çdo kërkese të saj.</p> <p>Në raste kontestimi, pedagogu i lëndës ofron gadishmérinë për të bërë sqarimet e nevojshme për studentët. Aty ku shihet e nevojshme, lektorët realizojnë konsulencë në lidhje me njojuritë e papërvetësuara mjafshëm nga studentët.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjinin në provime dhe detyra.	<p>Personeli akademik është përgjegjës për kontrollin dhe shmangien e plagiaturës si në provime dhe testime, po ashtu edhe në detyra dhe projekte. Për projektet, detyrat e kursit, dhe punimet shkencore institucioni ka vënë në dispozicion të personelit akademik një platformë softwerike e cila kontrollon nivelin e plagiaturës (Beder Plagiarism Checker System)<sup>225</sup>. Në rast se kontrolli i plagiaturës evidenton probleme të theksuara mbi standartin e punimit, pedagogu i lëndës udhëzon studentin për të kryer ndryshimet e nevojshme që punimi të përbushë standardet dhe etikën e kërkuar për një punim shkencore. Për të shmangur kopjinin gjatë provimeve, provimet realizohen në salla të mëdha me të paktën dy vëzhgues.<sup>226</sup> Në varësi të llojit të testimit pedagogu i lëndës pregatit dy ose më shumë teza për të minimizuar mungesat e kopjimit.<sup>227</sup></p>

<sup>219</sup> Evidencia nr. 93: Shembull provimi me testim elektronik

<sup>220</sup> Evidencia nr 91: Vendimi-I-KM-Nr.-41-datë-24.01.2018

<sup>221</sup> Evidencia nr.30: Shembull Sylabusi

<sup>222</sup> Evidencia nr. 94: Shembull i Transparencës ne Përcaktim të Kritereve dhe Vleresim\_Project Presentation

<sup>223</sup> Evidencia nr. 56: Organizimi i Provimeve Finale të Departamentit.

<sup>224</sup> Evidencia nr. 92: Shembull Provimi me Celësin e Zgjidhjeve

<sup>225</sup> <https://pds.beder.edu.al>

<sup>226</sup> Evidencia nr. 56: Shembull organizimi i provimeve finale

<sup>227</sup> Evidencia nr. 33: Rregullorja e disiplinës së studentëve



		Studentët njihen paraprakisht me rregulloren, kushtet dhe normat e sjelljes gjatë provimit, sikurse dhe masat disiplinore të ndërmara për çdo shkelje. <sup>228</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.		Paraqitja e rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bëhet nëpërmjet testeve sa më objektive. Vlerësimet e punëve individuale apo në grup jepen sipas meritës dhe në kohë sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (neni 23). <sup>229</sup> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale përcaktuar në kalendarin akademik, dhe personeli akademik është i detyruar t'i respektojë ato. Kalendari akademik është lehtësish në aksesueshëm në website-in zyrtar të KU "Bedër" <sup>230</sup> , sikurse dhe dërgohet me mail zyrtar në fillim të vitit akademik.			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njojur me vlerësimin, kërkësen për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.		Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njojur me vlerësimin, kërkësen për rishikim të vlerësimit duke e përcaktuar në Rregulloren Themelore, ku parashikohet se studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin e provimit (neni 102) <sup>231</sup> edhe në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të parë të Studimeve, neni 24 <sup>232</sup> . Po ashtu, rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", neni 28 shpjegon qartë se "Nëse studenti/ja ka pretendime ose ankesa kundrejt vlerësimit dhe rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai/ajo ka të drejtë që brenda një javë nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim pranë zyrës së sekretarisë mësimore". <sup>233</sup>			
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkësë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.		Në Guidën e studentit përcaktohet se "Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një javë nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim te Zyra e Sekretarisë Mësimore. Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të këshillit të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkësës për rishikim. Në rast të dorëzimit me shkrim të ankesës nga studenti/ja, ankimi shqyrtohet nga një komision i cili ngrihet me vendim të këshillit të departamentit përkatës dhe përbëhet nga tre anëtarë me përjashtim të pedagogut të lëndës". <sup>234</sup>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	X

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënieve dhe mësimnxënieve në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofron njohuri bazë dhe specifike në të dyja fushat e studimit që ndërthur, ekonomi dhe informatikë. Të gjitha lëndët e ofruara në këtë program studimi parashikojnë që të kenë çdo javë të paktën një orë praktikë/seminar, krahas orëve teorike të marra në leksion. Pedagogët përzgjedhin tekste që janë të integruar me praktikën, ose që janë kryesisht të aplikuar me qëllim thellimin e njohive dhe zhvillimin e aftësive profesionale e praktikës. Në varësi të lëndëve në këtë program studimi mundësohet një kombinim i mënyrave të ndryshme të mësimdhënieve: punë në laboratori për lëndët e fushave së informatikës;

<sup>228</sup> Evidencia nr. 28: Guida e Studentit,

<sup>229</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, neni 23.

<sup>230</sup> <https://beder.edu.al/sh/content/default/kalendar-akademik-2022-2023/5/589>

<sup>231</sup> Evidencia nr. 3: Rregullorja Themelore, neni 102.

<sup>232</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 24.

<sup>233</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike - Neni 28.

<sup>234</sup> Evidencia nr. 28: Guida e studentit (Apelimet)



	<p>pyetje kritike dhe analitike për problem-zgjidhje; raste studimore; analizë të artikujve shkencorë, duke i njojur studentët teorikisht dhe praktikisht me fushën që studiojnë.<sup>235</sup> Krahas teorisë, seminareve, projekteve, rasteve studimore dhe praktikave profesionale, përmes marrëveshjeve me kompani të ndryshme, studentët bëjnë praktika profesionale dhe internshipe<sup>236</sup> që mundësojnë thellimin e njojurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta për studentët.<sup>237</sup></p> <p>Duke marrë parasysh rëndësinë që i kushtohet praktikave profesionale, për monitorimin e mbarëvajtjes së tyre është hartuar edhe një paketë dokumentacioni me formularët e nevojshëm për t'u plotësuar gjatë ndjekjes së praktikës profesionale nga ana e studentëve, duke përfshirë formularin e vlerësimit të studentit praktikant, formular i miratimit të praktikës, raport mbi zhvillimin e praktikës, si dhe raportime të përvjashme në lidhje me zhvillimin e procesit të praktikës në insitucionet përkatëse.<sup>238</sup> Thellimi i njojurive të veçanta arrihet përmes kombinimit të komponentëve të ndryshme të transmetimit dhe matjes së njojurive të realizuara nga pedagogët përgjëgjës të lendeve, si: matja e aftësive komunikuese dhe prezantuese përmes prezantimit të detyrave të kursit dhe projekteve, aftësi të të punuarit në mënyrë të pavarrur dhe në grup përmes detyrave individuale dhe në grup; zhvillimi i mendimit kritik dhe analistik përmes zgjidhjes së problemve dhe rasteve studimore, etj. Plani i aktiviteteve ekstrakurikulare hartohet në mënyrë të tillë që secili aktivitet të thelojë njojuritë në një fushë të realizuar në auditor apo të formësosjë njojuri të veçanta dhe specifike të fushës së studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Simulim investimesh në pasuri të paluajtshme përmes, Shkolla Verore në FinTech<sup>239</sup>;</li> <li>• Investim në Bursa<sup>240</sup>;</li> <li>• Simulimi Enterprise Resource Planning (ERP)<sup>241</sup>;</li> <li>• Të mësuarit dhe të nxenit përmes sfidave-Konkursi SUSILO<sup>242</sup>.</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Programi i studimit në Bachelor në "Informatikë Ekonomike" mundëson thellimin e njojurive në mënyrë të përgjithshme dhe specifike në fushën e teknologjisë së informacionit përmes lëndëve të profitit të informatikës të cilat përbëjnë rreth 50% të kurrikulës, të tillë si: Programim në Web, Programim Java, Rrjete Kompjuterike, Programim i orientuar në objekte, etj. Në fushën e shkencave humane, kurrikula e programit siguron marjen e njojurive në lëndën Gjuhë e Huaj si dhe marrjen e njojurive nga fusha e drejtësisë nëpërmjet lëndës, E Drejtë Biznesi. Njojuritë e thelluara dhe aftësimi në fushat sociale, studentëve u garatohet përmes lëndëve të ekonomisë, si psh: Ekonomi, Hyrje në Financë, Kontabilitet, Menaxhim, Menaxhim Projektesh, etj. Zhvillimi i aftësive komunikuese është pjesë integrale e të gjitha lëndëve, por në mënyrë specifike mundësohet përmes lëndës Sjellje Organizative<sup>243</sup>.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" paraqiten në programin dhe syllabuset e çdo lënde, duke theksuar dhe kompetencat dhe aftësitë që kontribuon secila lëndë në të gjithë programin. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", në këtij te çdo semestri analizon syllabuset e lëndëve (lëndët e semestrit të kaluar dhe të semestrit në vitin).</p>

<sup>235</sup> Evidencia nr. 78: Shembull syllabusi - Programim në web.

<sup>236</sup> Evidencia nr. 45: Shembull aplikimi praktike.

<sup>237</sup> Evidencia nr. 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione.

<sup>238</sup> Evidencia nr. 45: Shembull aplikimi praktike.

<sup>239</sup> Kolegji Universitar Beder ([beder.edu.al](http://beder.edu.al))

<sup>240</sup> <https://trading.planspiel-boerse.de/web/auth/login?returnUrl=%2Faccount%2Ftraining%2Forders%2FEXECUTED>

<sup>241</sup> Kolegji Universitar Beder ([beder.edu.al](http://beder.edu.al)) / <https://buff.ly/49v22QS>

<sup>242</sup>

[https://www.youtube.com/éatch?v=KAc80XvJyvg&list=TLGGTL9C4d\\_IN\\_czMda5MjAyMë&ab\\_channel=QuestromSchoolofBusiness%2CBostonUniversity](https://www.youtube.com/éatch?v=KAc80XvJyvg&list=TLGGTL9C4d_IN_czMda5MjAyMë&ab_channel=QuestromSchoolofBusiness%2CBostonUniversity)

<sup>243</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike



rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe përdetyrimet përmbyllëse.	duke nxjerrë në pah aftësitë dhe kompetencat e çdo lënde me qëllim plotësimin e gjithë aftësive dhe kompetencave që parashikon programi i studimit. Një pjesë e rëndësishme e syllabuseve të programit janë "Course Outcomes", rezultatet e të nxënët nga studentët kjo në përputhje edhe me kërkesat e VKM nr. 41 datë 24.01.2018 <sup>244</sup> , duke orientuar drejtimin dhe zhvillimin e lëndëve gjatë semestrit, në shërbim të organizmit të lëndës nga stafi akademik në leksione, diskutime, seminare, testime dhe orët e ushtrimeve. Studentët njihen dhe orientohen që në fillim të semestrit me detyrimet përmbyllëse të lëndës nga pedagogu përkatës, duke vënë në dispozicion dhe metoda të ndryshme të matjes së kompetencave dhe aftësive. Në përfundim të semestrit, lektorët sigurohen (me anë të metodave të ndryshme vlerësuese të aplikuara, përfshirë këtu vlerësimin e vazhdueshëm në disa komponentë dhe vlerësimin përfundimtar) që objektivat e shprehura në syllabuset e lëndëve, të jenë arritur dhe plotësuar. Këto trajtohen në diskutim të lirë me studentët ku si pedagogët ashtu edhe studentët shprehin mendimet e tyre për njohuritë dhe shprehitë e fituara, çfarë i vlen pedagogut për të nxjerrë konkluzione përmirësimin e procesit në vijimësi. Në përfundim të lëndës, studentët kanë në dispozicion një pyetësor në lidhje me përfundimin e lëndës, duke analizuar në detaje çdo aspekt të lëndës dhe mënyrës se si pedagogu e ka zhvilluar atë, rezultate që shërbejnë përmirësimin e mësimdhënies në vijim. <sup>245</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirë përcaktuara në programet lëndore të programit të studimit. <sup>246</sup> Studentët e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme që të zhvillojnë aftësitë e tyre, përfshi aksesin në laboratorë kompjuterike, aksesin në bibliotekën e universitetit, aksesin në databazën JSTOR <sup>247</sup> . Praktika profesionale kryhet përmes marrëveshjeve me kompani të ndryshme dhe insitucionë qëndrore që operojnë në përputhje me profilin e programit të studimit. <sup>248</sup> Falë bashkëpunimit me institucionë publike dhe institucionë te tjera janë realizuar aktivitetet e përbashkëta për angazhimin e studentëve si psh: AMF për angazhimin e studentëve në investime në bursa; angazhim në simuliime si ERP i zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin Tor Vergata; angazhim në Challenge Based Learning, një komentacion ndërkombëtarë, ku marrin pjesë ekipe nga disa shtete; simulim mbi investimin në tregun e pasurive të paluajtshme përmes Fintech, etj. <sup>249</sup> Këto marrëveshje mundësojnë organizimin e praktikave të studentëve, zhvillimin e projekteve të përbashkëta, si dhe u hapin rrugë bashkëpunimeve të tjera në funksion të realizimit të aktivitetit dhe objektivave të programit të studimit. Hartimi i syllabusit të lëndës, bazuar në vlerësimin me shumë komponentë i vjen në ndihmë pedagogut për të matur nivelin e marrjes së kompetencave nga studentët. Po ashtu, në këtë mënyrë studenti ka mundësi të shprehë aftësitë dhe kompetencat e marra gjatë procesit mësimor. <sup>250 251</sup> Ndër elementët kryesorë të vlerësimit, përvèç formave bazë me provim, janë projektet e detyrueshme përmbylljen e lëndës, të cilët në varësi të specifikave hartohen si punë individuale ose në grup, dhe në varësi të lëndës këto punime mund të janë: analizim i rasteve studimore, zgjidhja e një problemi, analiza kritike të shembulleve të caktuara, zhvillimi i një ideje inovative të biznesit apo zhvillimi i një aplikacioni teknologjik përmes programeve të start-up-eve, sikurse është punë kërkimare në nivel.

<sup>244</sup> Evidencia nr. 91: VKM nr.41 më datë 24.01.2018, në lidhje me rezultatet e të nxënët.

<sup>245</sup> Evidencia nr. 34: Anketa e studentit ndaj lëndës

<sup>246</sup> Evidencia nr. 78: Shembull syllabusi - Programim në web.

<sup>247</sup> Evidencia nr. 81: Infrastruktura e Auditorëve, Laboratorëve dhe Bibliotekës

<sup>248</sup> Evidencia nr. 76: Marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucionë.

<sup>249</sup> [https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities\\_list/](https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities_list/)

<sup>250</sup> Evidencia nr. 30: Syllabusi i Lëndës e-Commerce

<sup>251</sup> Evidencia nr. 78: Shembull Syllabusi - Programim në web



	të moderuar si mënyrë përgatitore për procesin e përgatitjes së temës së diplomës në fund të programit.  Programi është i organizuar kryesisht me leksione dhe në lëndë të profilit, është i kompletuar me orë në laborator, ose seminare për lëndët që janë më teorike. <sup>252</sup> Nga ana tjetër, praktika profesionale është një lëndë e detyrueshme e cila zhvillohet në semestrin e gjashtë, dhe mundëson që studentët të arrijnë të zhvillojnë njohuritë e marra gjatë viteve të studimeve.  Studentët kanë marrë pjesë dhe kanë prezantuar punimin e tyre në konferanca shkencore, në institucionë partnerë apo konferenca studentore, si psh: pjesëmarrja në Konferencën e Universitetit të Korçës. <sup>253</sup>  Po ashtu, studentët janë angazhuar në mobilitetë në institucionet partnerë falë marrëveshjes së bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus. <sup>254</sup>								
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në fillim të çdo viti akademik, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive mësimore, departamenti harton një plan aktivitetesh <sup>255</sup> ndër të cilat përfshihen: leksione të hapura, seminare trajnuese, workshop-e, konferensa, etj. <sup>256</sup>  Të ftuarit në këto orë ekstrakurrikulare dhe të hapura mund të janë staf i brendshëm ose i jashtëm, specialistë të fushës dhe ekspertë nga universitete brenda e jashtë vendit. Një praktikë shumë e mirë në këto seminare dhe orë të hapura është përfshirja e temave ndërdisiplinore dhe zhvillimi i tyre me pjesëmarrje aktive të studentëve.  Stafi akademik i KU "Bedér" merr pjesë në mënyrë aktive në konferanca shkencore dhe publikon në mënyrë periodike në revista të indeksuara dhe me faktor impakti. Si praktikë e përgjithshme pedagogët nxiten që të bëjnë publikime që i shërbejnë lëndëve duke sjellë dinamikat më të fundit në fushat përkatëse dhe qasjet më inovative në këto fusha. <sup>257</sup>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th style="background-color: red;">Nuk përbushet</th> <th style="background-color: orange;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: yellow;">Përbushet kryesht</th> <th style="background-color: green;">Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesht	Përbushet plotësisht						
			X						

**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Diplomimi është një proces i mirë organizuar përmes procedurave dhe rregulloreve të miratuara nga institucioni. Punimi i diplomimit është pjesë e Rregullores Themelore të Institucionit (neni 88), <sup>258</sup> Rregullores së Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë (neni 15), <sup>259</sup> Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (neni 19) <sup>260</sup> ku saktësohen dhe detyrimet që studentët duhet të përbushin deri në diplomimin e tyre. Institucioni u vë në dispozicion studentëve Manualin për përgatitjen e temës së diplomës <sup>261</sup> i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët në faqen e institucionit. <sup>262</sup> Për procesin e diplomimit studentët e

<sup>252</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula-Bachelor ne Informatike Ekonomike

<sup>253</sup> <https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities/transformimi-dixhital-ne-kohen-e-sfidave-3/1967>

<sup>254</sup> Evidencia nr. 104. Shkëmbi i studentëve

<sup>255</sup> Evidencia nr. 70: Plani i Aktiviteteve për Vitin akademik 2023-2024

<sup>256</sup> [https://ecobus.beder.edu.al/sh/ne%C5%87s/activities\\_list/](https://ecobus.beder.edu.al/sh/ne%C5%87s/activities_list/)

<sup>257</sup> Evidencia nr. 67: Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023, Tabela e Publikimeve të Staftit

<sup>258</sup> Evidencia nr. 3: Rregullorja Themelore, neni 88.

<sup>259</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 15.

<sup>260</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, neni 19.

<sup>261</sup> Evidencia nr. 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë

<sup>262</sup> <https://mco.beder.edu.al/uploads/docs/guidelineShqip.pdf>



	<p>programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" mund të zgjedhin t'i nënshtrohen provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të përgatisin një punim diplome.<sup>263</sup> Me propozim nga këshilli i departamentit të ekonomisë dhe biznesit dhe me miratim nga senati akademik, rregullorja e programit të studimit neni 19 ka përcaktuar qartë dhe në mënyrë eksplikite kushtet për të zgjedhur midis një punimi diplome apo provimit të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Provimi ose punimi i diplomës realizohet në kuadër të lëndës semestrale. Si kriter minimal për të vendosur, nëse studenti do t'i nënshtrohet provimit përfundimtar apo punimit të tezës, është mesatarja e akumuluar 3.00 nga 4.00.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përbyllëse.	<p>KU "Bedër" bën publik informacionin rreth provimeve finale dhe mbrojtjes së diplomave në përputhje me Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Parë.<sup>264</sup> KU "Bedër" po ashtu, në funksion të procesit të diplomimit vë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme përmes Manualit të Tezës.<sup>265</sup> Në rregulloren programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (neni 19), parashikohet kryerja e një punimi diplome.<sup>266</sup> Kriteret e kryerjes së punimit, provimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohen nga deparamenti përgjegjës për programin e studimit. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor.<sup>267</sup></p> <p>Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët përmes përcaktimit të udhëheqësit të diplomës. Udhëheqësit e diplomave dhe lektorët e përcaktuan për lëndën e provimit përfundimtar,<sup>268</sup> kanë rol kyç në përcjelljen e këtij informacioni dhe në ndjekjen e procesit hap pas hapi, me seanca metodologjike dhe sipas një kalendari takimesh. Procedura për cilëndo nga mënyrat, provim apo tezë, parashikon asistencë nga pedagogët, udhëzime të qarta për studentët dhe materiale ndihmëse në funksion të këtij procesi. Pas konfirmimit të bërë nga udhëheqësi i tezës, studenti duhet të prezantojë punimin e tij në juri, e cila vepron si komision që vlerëson nivelin shkencor të punimit të diplomës. Pjesë e manualit për përgatitjen e punimit të diplomës janë dhe kriteret e vlerësimit të punimit për studentët e ciklit të parë që e bëjnë procesin edhe më transparent.<sup>269</sup></p>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final ngritet me vendim të këshillit të departamentit para fillimit të semestrit të VI-të dhe pasqyrohet në ngarkesën mësimore, e cila më pas miratohet në fakultet dhe rektorat.</p> <p>Me vendim të Këshillit të Departamentit janë përcaktuar të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike të cilat do të përfshihen në provimin final.<sup>270</sup> Studentëve u vihet në dispozicion një "fond pyetjesh" dhe mbi këto pyetje hartohet provimi përfundimtar.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<p>Udhëheqësi i diplomës ka një rol të rëndësishëm në orientimin dhe përgatitjen e studentëve në prag diplomimi dhe përcaktohet me vendim të këshillit të departamentit përpjaka fillimit të semestrit të VI-të.</p> <p>Departamenti shqyrtion propozimet e studentëve mbi temat, dhe garanton që temat të janë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe profilin e ngushtë akademik dhe profesional të lektorëve udhëheqës. Udhëheqësi i diplomës mbështet studentët për përzgjedjen e temës, strukturimin e saj, aplikimin e metodologjisë përkatëse, analizimin e të dhënavë, etj., në përputhje me Manualin për përgatitjen e tezës së diplomës.<sup>271</sup> Për të siguruar mbarëvajtjen e punimit dhe garantimin e cilësisë së punimit, institucioni ka hartuar një formular raportimi periodik në lidhje me ecurinë e punimit.<sup>272</sup> Në përputhje me udhëzimin për përgatitjen e punimit të diplomimit, udhëheqësi mbështet studentët edhe në hartimin e konkluzioneve dhe përpilimin e listës përkatëse të literaturës të përdorur si referencë. Me miratimin e udhëheqësit të diplomës punimi mund të kalojë më tej dhe të paraqitet para komisionit.</p>

<sup>263</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, neni 19.

<sup>264</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 15.

<sup>265</sup> Evidencia nr. 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë.

<sup>266</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, neni 19

<sup>267</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor në Informatikë Ekonomike

<sup>268</sup> Evidencia nr. 105: Lëndët që do të përfshihen në provimin përfundimtar, Programi Bachelor në Informatikë Ekonomike.

<sup>269</sup> Evidencia nr. 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë.

<sup>270</sup> Evidencia nr. 105: Lëndët që do të përfshihen në provimin përfundimtar, Programi Bachelor në Informatikë Ekonomike.

<sup>271</sup> Evidencia nr. 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë.

<sup>272</sup> Evidencia nr. 90: Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit.



<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjetet e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>Përgjegjësia kryesore për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës i jepet udhëheqësit të diplomës. Ai asiston dhe ndërmjetëson studentët në lidhje me nevoja të caktuara kundrejt institucionit, në kuadër të përgatitjes me sukses të punimit të diplomës në përpunim me manualin e miratuar nga KU "Bedër" për përgatitjen e tezës së diplomës.<sup>273</sup></p> <p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve të gjithë infrastrukturën e tij, si psh: kontaktet me kompanitë për intervistat, rastet studimore, bibliotekën online (JSTOR)<sup>274</sup>. Gjatë periudhës së provimeve dhe punimit të tezës, laboratori i kompjuterëve dhe biblioteka qëndrojnë të hapura dhe në fundjavë.</p>								
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	<p>Mbrojtja e temës së diplomës bëhet me gojë dhe studenti vlerësohet me notë nga një komision në përfundim të punimit të diplomës.<sup>275</sup> Nota arkivohet pranë koordinatores së departamentit dhe u shfaqet studentëve në listën e notave të studentit në profilin e tyre në BIS. Përbërja e komisionit miratohet nga këshilli i departamentit përgjegjës për programin e studimit. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, specialistë të fushës së temës së përzgjedhur nga studenti.</p>								
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Studenti, i cili ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e parashikuara në kurrikulën përkatëse të programit të studimit dhe ka përbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", pajiset me diplomë dhe suplementin e saj, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Kërkesat e procedurës së diplomimit lidhen me: kërkesat për kredite ECTS dhe kërkesat për notën mesatare minimale.<sup>276</sup> Kjo procedurë realizohet nga Sektretaria Mësimore nëpërmjet sistemit BIS.</p> <p>Kundrejt kërkesës së studentit, në përfundim të studimeve studenti pajitet me diplomën dhe suplementin e diplomës. Institucioni, gjithashtu, vë në dispozicion kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, në përfundim të studimeve.<sup>277</sup></p> <p>Vlen për t'u saktësuar këtu që në programin Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve dhe ky është akreditimi i parë përkështues.<sup>278</sup></p>								
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>KU "Bedër" parashikon në Rregulloren Themelore ruajtjen dhe arkivimin e të dhënavë.<sup>279</sup> Dokumentacioni i të dhënavës të diplomimit të studentëve dhe përformancës së tij ruhet për një periudhë të pacaktuar nga Zyra e Regjistrimit<sup>279</sup> dhe Arkiva e KU "Bedër".<sup>280</sup></p> <p>Çdo dokument është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, ndër të tjera, dosjen e studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, etj. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar ose të caktuar sipas detyrimeve ligjore kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen, sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.<sup>281</sup></p>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <th style="background-color: red; color: white;">Nuk përbushet</th> <th style="background-color: orange; color: white;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: yellow; color: black;">Përbushet kryesisht</th> <th style="background-color: green; color: white;">Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

<sup>273</sup> Evidenca nr. 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë.

<sup>274</sup> Evidenca nr. 80: Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe bibliotekës.

<sup>275</sup> Evidenca nr. 6: Rregullorja e Ciklit të Parë të Studimeve, neni numër 19. Punimi i i Diplomimit.

<sup>276</sup> Evidenca nr. 6: Rregullorja e Ciklit të Parë të Studimeve, neni 28. Përfundimi i Studimeve dhe Diploma.

<sup>277</sup> Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore, neni 109. Lëshimi i Diplomës. Suplementi i Diplomës.

<sup>278</sup> Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore, neni 47.

<sup>279</sup> Evidenca nr. 18: Rregullorja e zyrës së sekretarise mësimore.

<sup>280</sup> Evidenca nr. 9: Rregullorja e Arkivës, neni 6.

<sup>281</sup> Evidenca nr. 9: Rregullorja e Arkivës, neni 6.



## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi IV.1

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standartet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënieς të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, përfshin kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik efektiv dhe me kontratë në KU "Bedër" që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. <sup>282</sup> Departamenti siguron rekrutimin e stafit akademik të kualifikuar, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Në këtë program angazhohet personel efektiv dhe me kontratë me tituj e grada shkencore, si 2 anëtarë Profesor i Asociuar, 2 anëtarë Doktor Shkencash dhe 6 anëtarë Master Shkencash, dy prej të cilëve në proces doktorature <sup>283</sup> , në profilet financë, menaxhim, teknologji informacioni duke përbushur kështu kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik. <sup>284, 285</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore e stafit akademik në KU "Bedër" është e organizuar dhe e balancuar në mënyrë efektive për të përbushur ngarkesën mësimore të personelit akademik efektiv në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe udhëzimin e brendshëm <sup>286</sup> . Në fillim të çdo semestri, me vendim të këshillit të departamentit, i cili më pas miratohet në strukturat përkatëse, bëhet shpërndarja e lëndëve dhe emërimi i lektorëve. <sup>287</sup> Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" në përputhje me kornizën ligjore në fuqi duke mbuluar të paktën 70% të orëve në auditor. <sup>288</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Zyra e Burimeve Njerëzore zoteron të gjithë dokumentacionin e plotë të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. <sup>289</sup> Gjithashtu institucioni dëshmon se personeli akademik është i qëndrueshëm pasi të gjithë lektorët e angazhuar në këtë program studimi kanë një periudhë punësimi të konsiderueshme pranë institucionit siç paraqitet edhe në tabelat përbledhëse. <sup>290</sup> Në tabela jepet informacion në lidhje me stafin e angazhuar në departament përfshirë përgjegjësin e Departamentit si person përgjegjës për organizimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".

<sup>282</sup> Evidencia nr. 54: CV-të e stafit akademik

<sup>283</sup> Shtoja: Tabela nr. 7: Të dhënat përbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet mësimor

<sup>284</sup> Evidencia nr. 54: CV-të e stafit akademik

<sup>285</sup> Shtoja: Tabelat nr. 1 dhe nr. 2: Numri i personelit akademik përfshirë kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA) dhe PA).

<sup>286</sup> Evidencia nr. 20. Udhëzim përfshirë ngarkesën mësimore

<sup>287</sup> Shtoja: Tabela nr. 4: Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Informatikë Ekonomike në një vit akademik.

<sup>288</sup> Shtoja: Tabela nr. 12: Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës.

<sup>289</sup> Evidencia nr. 95: Kontratë pune individuale me kohë të plotë e stafit akademik.

<sup>290</sup> Shtoja: Tabela nr. 12: Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës.



<sup>291</sup> Evidenca nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, KREU XV, nen 61.

<sup>292</sup> Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore, Kreu 6, nen 26.

<sup>293</sup> Evidenca nr. 23: Procedura e rekrutimit të stafit akademik

<sup>294</sup> Evidenca nr. 116 Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë.

<sup>295</sup> Evidence no. 82, Štúria, 1990, Bratislavský Rajón de tým, p. 12.

--- Evidenca nr. 83: Shkresa derguar Drejtorisë Rajonale te  
296

<sup>296</sup> Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore, Kreu 6, nen 26.

<sup>297</sup> Evidenca nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 63, Pika A.



biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshmë, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimitari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	studentëve, trajnimeve profesionale, praktika studentore, organizimin e konferencave ndërkombe të projekteve të përbashkëta kërkimore. <sup>299</sup> KU "Bedér" u ofron studentëve mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale në institucionë të ndryshme brenda vendit, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje ndër vite. Departamenti cakton një pedagog përgjegjës për caktimin dhe ndjekjen e praktikës profesionale <sup>300</sup> dhe punimit të diplomës. Nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës, organizimit të leksioneve të hapura, seminareve profesionale, të ftuarve të ndryshëm, <sup>301</sup> etj., studentët e KU "Bedér" informohen hollësisht për mundësitë e punësimit pas diplomimit në këtë program studimi.										
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktika Profesionale është një veprimtari formuese akademike, e cila vlerësohet me notë dhe ka 4 kredite <sup>302</sup> . Gjatë saj studentit i kërkohet të zgjerojë dhe zbatojë njohuritë e marra në auditor për të fituar aftësi shtesë brenda një mjedisit praktik profesional, në kuadër të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", duke përbushur kërkësat dhe standarde e njohura etike, profesionale dhe ligjore. KU "Bedér" në kuadër të planifikimit të karrierës, krasas zyrës së planifikimit të karrierës pranë çdo departamenti cakton një përfaqësues i cili do t'i ndihmojë studentët në kërkimin dhe përcaktimin e një vendi të përshtatshëm për realizimin e praktikës profesionale. <sup>303</sup> Gjithashtu, përfaqësuesi përgatit një plan praktike profesionale në bashkëpunim me mbikëqyrësin në ambientin pritës dhe studentin, duke specifikuar qëllimet dhe objektivat e praktikës, ndjekjen për përbushjen e tyre, si dhe shkrimin e vlerësimin e Raportit të Praktikës Profesionale. <sup>304, 305</sup>										
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th></th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht		Përbushet plotësisht					X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht		Përbushet plotësisht							
				X							

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mëdise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mëdiset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimitarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni ofron kushtet dhe pajisjet e nevojshme të punës për zhvillimin e veprimitarisë mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Ambientet kanë një infrastrukturë bashkëkohore dhe përbëhen nga 17 klasa, 1 sallë konferencash, 4 laboratorë, sallë gjyqesh, News Room, të cilat përdoren për aktivitete mësimdhënëse. Gjithashtu, përveç auditorëve, ka dhe shumë ambiente çlodhëse për studentët si bibliotekë, mëdise për Këshillin Studentor dhe klubet studentore, etj. Ambiente të tjera shlodhwse pwrfshijnw edhe kafetinw, kalçeton dhe fusha e voleibollit. Vlerë e shtuar është edhe prezenca e parkimit të institucionit i cili ofrohet falas për studentët dhe stafin. Lokacioni shumë pranë qendrës së qytetit e bën institucionin lehtësish të aksesueshëm për studentët dhe stafin. Përveç ambienteve që ofrohen brenda 2 godinave kryesore, vlerë e shtuar janë edhe

<sup>299</sup> Evidencia nr. 75: Lista e marreveshjeve institucionale dhe Erasmus +.

<sup>300</sup> Evidencia nr. 55: Procedura e praktikës profesionale.

<sup>301</sup> [https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities\\_list/](https://ecobus.beder.edu.al/sh/news/activities_list/)

<sup>302</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor ne Informatike Ekonomike.

<sup>303</sup> Evidencia nr. 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës.

<sup>304</sup> Evidencia nr. 55: Procedura e praktikës profesionale.

<sup>305</sup> Evidencia nr. 45: Shembull aplikimi praktike.



	ambientet e jashtme çlodhëse që pasurojnë në shumë dimensione jetën studentore, brenda hapësirës së institucionit. <sup>306</sup>			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjetë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Ambientet e mësimit janë të pajisura me kompjutera, video-projektorë, internet dhe tabelë interaktive që mundësojnë mbarëvajtjen normale të procesit mësimor. <sup>307</sup> Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm. Adoptimi dhe shpërndarja e hapësirave të institucionit në dy godina, bazohet në një qasje sa më racionale dhe objektive. Në godinën A, e cila është në hyrje të institucionit, përqendrohen kryesisht ambientet e administratës, holli, biblioteka, etj., dhe në godinën B janë të përqendruara auditorët e leksioneve dhe laboratorët kompjuterikë. News Room, një prej risive të KU "Bedër", është një ambient i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, i cili mund të përdoret edhe nga departamentet e tjera. News Room përbëhet nga kompjutera dhe tavolina leximi, si dhe mund të përdoret në të njëjtën kohë edhe si laboratori kompjuteri.			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkeseve të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në institucion ka gjithsej 128 kompjutera për studentët, 4 laboratorë të mobiluar me kompjutera (PC), 1 sallë bibliotekë të gjitha të disponueshme për studentët për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e tyre arsimore. <sup>308</sup> Kompjuterat kanë të instaluar të gjitha programet e nevojshme softwerike të përdorura nga studentët e programit të studimit. Gjithashtu, studentët dhe stafi kanë akses në internet brenda kampusit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laboratori teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale për të përmbushur nevojat e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". <sup>309</sup>	KU "Bedër" disponon katër laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale për të përmbushur nevojat e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". <sup>309</sup>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

**Standardi IV.3**

**IV.3 Programi i studimit duhet të përbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmë e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digitale) garanton marrjen e dijeve dhe njojurive të nevojshme, të	Studentëve u prezantohen, në fillim të çdo lëndë, literatura bazë dhe mbështetëse të duhura për përvetësimin e njojurive dhe aftësive në përpjekjen e programin e studimit. Në KU "Bedër", të gjithë studentët dhe stafi akademik janë anëtarë të bibliotekës dhe kanë akses në shërbimet e saj. Ata mund të huazojnë materialë të bibliotekës duke ndjekur rregulloren e saj. <sup>310</sup>

<sup>306</sup> Shtoja: Tabela nr. 16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë.

<sup>307</sup> Evidenca nr. 81: Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër.

<sup>308</sup> Evidenca nr. 81: Infrastruktura e auditorëve, laboratorëve dhe Bibliotekës në KU Bedër.

<sup>309</sup> Shtoja: Tabela nr. 16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë .

<sup>310</sup> Evidenca nr. 37: Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës



parashikuara në programin e studimit.	Biblioteka ofron një gamë të gjerë librash të kategorizuara sipas fushave dhe temave. Këto libra janë në dispozicion si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë angleze. Për zgjedhja e librave bazohet në nevojat dhe kërkzesat e programeve të studimit, duke siguruar që literatura të përputhet me plan programet përkatëse të çdo lende. Gjithashtu, biblioteka ofron edhe materiale në format digitale nëpërmjet platformës JSTOR. <sup>311</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimë të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në fillim të çdo viti akademik këshilli i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit gjatë diskutimeve në lidhje me përditësimin e syllabuseve të lëndëve, diskuton në lidhje me përditësimin e literaturës bazë dhe ndihmëse me botime të viteve të fundit. <sup>312</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ofron një numër të konsiderueshmë tekstesh dhe literature plotësuese në ambientet e bibliotekës. Biblioteka zoteron tituj kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi dhe është e shfrytëzueshme në mënyrë të barabartë nga studentët. <sup>313</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e KU "Bedër" vjen në shërbim të studentëve dhe stafit me kapacitet 24 poste leximi dhe 8 kompjutera në funksion të saj. Në bibliotekë gjenden 22600 tituj shkencorë, 26000 libra shkencorë, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore. <sup>314</sup> Biblioteka është e abonuar në revista shkencore online, si JSTOR duke mundësuar përdorimin e më shumë se 12 milionë artikujve të revistave shkencore. <sup>315</sup> Gjithashtu, departamenti është abonuar në revisten Monitor dhe Business Magazine, duke bërë të mundur aksesin në versionin digital dhe fizik.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	KU "Bedër" ka anëtarësim të plotë në JSTOR <sup>316</sup> , një bibliotekë dixhitale e përbashkët e krijuar në 1995 që përfshin më shumë se 2,000 revista akademike. JSTOR u themelua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të kalojnë aktivitetet e tyre nga shtypja në operacione dixhitale, për të zgjeruar aksesin në përbajtjen shkencore në mbarë botën dhe për ta ruajtur atë për brezat e ardhshëm. Të gjithë studentët dhe anëtarët e stafit kanë akses në koleksionet e JSTOR me anë të emailit institucional në linkun <a href="http://www.jstor.org/">http://www.jstor.org/</a> , ku mund të kërkojnë, shfletojnë ose shkarkojnë artikuj të ndryshëm. Biblioteka e KU "Bedër" mundëson aksesin edhe në Book Academic Collection. Gjithashtu, departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit është abonuar në revistën Monitor dhe Business Magazine, duke bërë të mundur aksesin në versionin digital dhe fizik.
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e KU "Bedër" është e pajisur me kompjutera dhe programe kompjuterike për t'u mundësuar studentëve realizimin e detyrate dhe mundësi për akses online në varësi të nevojave të tyre.
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje	Oraret e punës së bibliotekës shpalen në mjediset e institucionit. Ato janë të bëra publike në hyrje të bibliotekës, mjediset e së cilës janë të disponueshme nga ora 8:30 deri në orën 19:00 të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës. Në funksion të bibliotekës, KU "Bedër" ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës së cilat janë mësuar

<sup>311</sup> Evidencia nr. 26: Marrëveshja për akses në JSTOR.

<sup>312</sup> Evidencia nr. 112: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve

<sup>313</sup> Shtoja: Tabela nr. 17: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online

<sup>314</sup> Shtoja: Tabela nr. 17: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online

<sup>315</sup> Evidencia nr. 26: Marrëveshja për akses në JSTOR

<sup>316</sup> Evidencia nr. 26: Marrëveshja për akses në JSTOR



edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	e studentëve bëhen në formë elektronike.								
<b>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitet përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</b>	KU "Bedër" parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës. Departamenti në fillim të vitit akademik pas konsultimit me lektorët dërgon kërkesat për literaturën e nevojshme. <sup>317</sup> Pasurimi i bibliotekës është bërë gjithashtu edhe përmes një projekti studentor "Libri është i vetmi kopësht që mbillet për të tjerët", i organizuar përmes një fushate sensibilizuese për mbledhjen e librave, në kuadër të së cilës u mblohdhën rreth 10 000 libra. Një pjesë e tyre u përdor për pasurimin e bibliotekës së institucionit, ndërsa pjesa tjeter u dhurua për shkolla, institucionet të tjera dhe grupe në nevojë. Një nismë tjeter që ka kontribuar në pasurimin e bibliotekës së KU "Bedër", ka qenë edhe dhurimi i 318 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë.								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</b>	Çdo studenti të regjistruar në KU "Bedër" në të gjitha ciklet i jepet një llogari zyrtare e emailit (llogari gmail). Me emailin e tij, studenti mund të identifikohet në llogarinë e tij personale studentore në Bedër Information System (BIS). Ndërsa qaja e studentëve ofron të gjitha detajet në lidhje me informacionin akademik të studentëve në KU "Bedër", duke përfshirë lëndët, notat, pjesëmarrjen në mësim, informacionin në lidhje me pagesat e kësteve, si dhe informacionin personal të studentit. Sistemi ofron informacion për periudhën akademike të studentit. <sup>318</sup>
<b>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</b>	Sistemi BIS mundëson administrimin dhe qarkullimin e informacionit, si dhe gjurmimin e aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Në BIS, të gjitha njësítë e mëposhtme kanë një llogari ku bëjnë veprimet në lidhje me detyrat perkatëse: Koordinatorët (koordinatorët e departamenteve dhe fakulteteve) për caktimin e lëndëve dhe monitorimin e aktivitetit akademik; Zyra e Sekretarisë Mësimore për të menaxhuar të gjithë informacionin personal të studentëve; Zyra e Financës dhe çështjeve administrative për të menaxhuar dhe përcjellë të gjithë informacionin financiar të studentëve; Zyra e Burimeve Njerëzore për të menaxhuar të gjitha të dhënat e informacionit të stafit dhe takton rolet dhe pozicionin e punës për secilin staf. <sup>319</sup> Gjithashtu çdo anëtar i stafit akademik ka llogari në BIS ku pasqyrojnë detajet e lëndëve, vlerësimet e studentëve, etj.
<b>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të</b>	Me anë të BIS studentët mund të kenë akses në të dhënat e tyre personale, si dhe në lidhje me programin e studimit. Regjistrimi i lëndëve beflet përmes këtij sistemi dhe studentët mund të shikojnë aktivitetin e vazhdueshëm akademik të lëndëve të

<sup>317</sup> Evidencia nr. 86: Kërkesa për literaturë.

<sup>318</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).

<sup>319</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).

gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>regjistrues gjatë semestrit. Ata mund të kontrollojnë pjesëmarrjen, notat e ndërmjetme dhe notat përfundimtare. Gjithashtu, në sistem, ata mund të aksesojnë planin mësimor të programit, transkriptin, llogaritjen e notave, kërkesat dhe njoftimet. Për më shumë informacion referojuni udhëzuesit të BIS.<sup>320</sup></p> <p>Stafi akademik, duke përfshirë pedagogë me kohë të plotë dhe të pjesëmarrjeve, mund të ketë akses në lëndët e tyre të caktuara në semestrin aktual dhe gjithashtu mund të shikojë lëndët e caktuara më parë. Pedagogët mund të përditësojnë programin e lëndës, të plotësojnë pjesëmarrjen e studentëve, të caktojnë dhe të finalizojnë notat.<sup>321</sup></p>								
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	<p>BIS, gjithashtu mundëson sinkronizimin dhe transferimin e të dhënave nga njëra njësi tek tjetra, nga njësitë te studentët, me qëllim mbajtjen dhe ofrimin e të dhënave të përditësuara njësive dhe studentëve në çdo kohë.</p> <p>Këshilltarët akademik mund të kenë akses në informacionin akademik të studentëve të caktuar për këshillim dhe ata mund të miratojnë regjistrimin e lëndëve të studentëve.<sup>322</sup></p> <p>Gjithashtu, për të siguruar një komunikim interaktiv mes pedagogëve dhe studentëve përdoret edhe platforma Google Classroom, e cila aksesohet duke përdorur email-et e hapura nga KU 'Bedër'.</p>								
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<p>BIS garanton monitorimin dhe raportimin në kohë reale të veprimtarisë akademike dhe administrative. Është një sistem modular i organizuar sipas roleve dhe njësive përkatëse në universitet dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënat të centralizuar. Të gjithë përdoruesit kanë akses në të dhënat e tyre personale, mund të përditësojnë detajet e përgjithshme dhe CV-në dhe mund të menaxhojnë detyrat dhe aktivitetet e lidhura me punën sipas rolit dhe pozicionit të tyre të punës.</p> <p>Këshilltarët akademik kanë akses në informacionin akademik të studentëve të caktuar për këshillim kurse autoritetet drejtuese në raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale.</p>								
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Në faqen zyrtare të institucionit gjendet informacion i përditësuar në lidhje me njësitë akademike dhe administrative, programet e studimit, burimet njerëzore, personelin akademik dhe administrativ të përfshirë në secilin program, si dhe veprimtaritë e njësive përkatëse.<sup>323</sup></p> <p>Në web jepet gjithë informacioni i nevojshëm për studentët përsa i përket kalendarit akademik, orarit të leksioneve dhe provimeve, si dhe një akses i dedikuar për bibliotekën dhe zyrën e kërkimit shkencor.</p> <p>Gjithashtu, publikohen njoftime pune apo për praktika profesionale, thirrje për mobilitetë për studentët dhe stafin, si dhe rezultate të anketave të zhvilluara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë apo komisioneve të tjera që operojnë pranë KU "Bedër". I gjithë informacioni ofrohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.</p>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						

<sup>320</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Beder (BIS).

<sup>321</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Beder (BIS).

<sup>322</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Beder (BIS).

<sup>323</sup> <https://www.beder.edu.al/>



**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit përfshirë paktën një cikël të plotë studimi.	Çdo vit, fondacioni "Hafiz Ali Korça" harton një raport ku parashikohen të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit të detajuara sipas llojit. KU "Bedër" gjëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës. Një mbështetje e madhe financiare për institucionin janë donacionet. Institucioni siguron që të ketë të ardhura të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. <sup>324</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative përmirësuar e mjetave dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituar dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjera.	Projektbuxheti i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit <sup>325</sup> pasqyron të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që departamenti ka, të cilat janë të detajuara sipas llojit, burimit dhe destinacionit të tyre. Në projektbuxhet janë të specifikuar të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për shërbimet që departamenti ofron, në mënyrë direkte apo indirekte. Gjithashtu, të gjitha shpenzimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative përmirësuar e mjetave dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, etj gjendet në raportet e zyrës së financës. <sup>326</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financier të tij.	Çdo vit, një kontabilist i miratuar harton një raport të situatës financiare të fondacionit "Hafiz Ali Korça" dhe ky raport ruhet pranë Fondacionit.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të viti paraardhës.	Raportet financiare hartohen sipas legjislativës së fundit të KU "Bedër", brenda afateve të përcaktuara, ku përfshihen pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në fund të çdo viti akademik, KU "Bedër" i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit reportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i viti të kaluar, projektbuxheti i viti të ardhshëm akademik <sup>327</sup> , si edhe projektbuxheti afatmesëm.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare përmirësuar veprimitarë e deri tanishme, KU "Bedër" dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit të zhvillimit të mbështetjen e donatorëve ka kapacitete të mjaftueshme financiare për përshtatësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të komodososur në ardhmen. Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KU "Bedër" behet në bazë të një programi financiar, i hartuar në përpunim me Standardet Komitetare të harqimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkoiara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH", në ligjin nr. 81/2001 datë 20.02.2001	

<sup>324</sup> Shtoja: Tabela nr. 8: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit

<sup>325</sup> Evidenca nr. 79: Projekt Buxheti i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit

<sup>326</sup> Shtoja: Tabela nr. 18: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit

<sup>327</sup> Evidenca nr. 79: Projekt Buxheti i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit

diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	"Për organizatat jofitimprurëse", në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b> <b>X</b>

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b> <b>X</b>
---	--------------------------	---------------------------------	--------------------------------	---



Handwritten signatures in blue ink, appearing to be signatures of the signatories.



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</b>	<p>Institucioni harton dhe ndjek me përpikmëri rrugolloren në fuqi për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë. Regjistrimi bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Pas fazës së regjistrimit, studenti pajiset me llogarinë elektronike nëpërmjet së cilës mban kontakt të brendshëm më të gjithë strukturat e institucionit, si dhe ndjek në mënyrë të detajuar ecurinë e tij gjatë ciklit të plotë akademik. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë paraqet me detaje të gjitha çështjet studentore që nga fillimi i studimit, deri në mbyllje të studimeve.<sup>328</sup></p> <p>Gjithashtu, studentët në momentin e regjistrimit njihen dhe me Guidën e Studentit e cila reflekton në mënyrë të detajuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentit përgjatë ciklit akademik. Kjo guidë është hartuar në mënyrë të tillë që të orientojë dhe ndihmojë studentët në përshtatjen dhe mbarëvajtjen e studimeve, si dhe të adresojë plotësisht çështjet kryesore me të cilat një student ndeshet gjatë ciklit akademik.<sup>329</sup></p> <p>Së fundmi, Rregullorja Themelore përcakton me përpikmëri të gjithë strukturën hierarkike të KU "Bedër" si dhe specifikon në mënyrë të quartë funksionin e seçilit entitet në brendësi të institucionit. Kjo rregullore është hartuar dhe zbatohet nga institucioni për të siguruar një infrastrukturë mësimore të organizuar në bazë të legjislacionit dhe akteve rregullatore në fuqi.<sup>330</sup></p>
<b>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</b>	<p>KU "Bedër" aplikon kriteret e cilat janë universale dhe garantojnë barazinë e të drejtat e seçilit kandidat që nga faza e regjistrimit, si dhe për të gjithë studentet e regjistruar pranë një program studimi. Kriteret e pranimit të cilat zbatohen në mënyrë unanime janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, të aksesueshme lehtësish në website-in zyrtar të institucionit.<sup>331</sup> Statuti i KU "Bedër" garanton barazinë dhe të drejta për të gjithë studentët e programit të studimit, të cilat parashtron konkretnisht në Kreun 15, Neni 98.<sup>332</sup> Institucioni ndjek politika lehtësuese dhe të veçanta për studentët me aftësi ndryshe.<sup>333</sup> Në vijim, elementet e spikatur në fitimin e çmimeve dhe arrijeve të shkëlqyera në studime përfitojnë mbështetje për studimet e tyre si zbritje të tarifës mësimore deri në 100% të vlerës<sup>334</sup>. Gjithashtu, në përputhje me rregulloren në fuqi KU "Bedër" publikon kriteret e pranimit për studentët e rinj në faqen zyrtare të institucionit si dhe mund të aksesohen lehtësish dhe nga portali U-Albania.<sup>335</sup></p> <p>Rregullorja Themelore si dhe Rregullorja e studimeve të ciklit të parë parashikojnë kriteret për procesin akademik të studentëve, kalimin e tyre nga njëri vit në tjetrin dhe fazën e diplomimit. Gjithashtu, aplikantëve u jepet mundësia të sulqojn interesin e tyre për rregjistrim në KU "Bedër" përmes një formulari interaktiv, i cili njëkohësisht</p>

<sup>328</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë - Neni 5, 11, 28.

<sup>329</sup> Evidencia nr. 28: Guida e Studentit.

<sup>330</sup> Evidencia nr. 3 : Rregullorja Themelore - Kreu 10, Neni 57. Kreu 11 - Neni 78, 89, 91.

<sup>331</sup> <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-19-18/6/151>

<sup>332</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i Kolegit Universitar Beder. Kreu 15 - Neni 98.

<sup>333</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë. - Neni 33

<sup>334</sup> Evidencia nr. 59: Miratimi i llojeve të zbritjeve të tarifave të studimit

<sup>335</sup> Evidencia nr. 22: Vendim Senati mbi kriteret e pranimit të studentëve.



	<p>me ndjekjen e procedurës së regjistrimit nga portali U-Albania, mundëson një informacion paraprak lidhur me kërkesat e aplikantëve dhe programet e studimit.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpresa çdo viti akademik kriterë të veçanta për përgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	<p>KU Bedër harton dhe publikon kriteret të veçanta për përgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programet e studimeve. Kriteret e listuara më poshtë, si dhe kriteret specifike për secilin program studimi mund te gjenden në faqen zyrtare të institucionit.<sup>336</sup></p> <p>1- Mesatarja e ponderuar e tre viteve të shkollës së mesme, në masën e ndikimit 70%.          2- Intervista me studentit në prani të komisionit të vlerësimit, në masën 30%. Komisioni ngrihet me vendim nga Këshilli i Departamentit përkatës.<sup>337</sup> Kriteret janë miratuar me vendim të senatit sipas ligjit në fuqi për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.<sup>338</sup> Kriteret parashikojnë dhe regjistrimin e studentëve të huaj. Informacionet e detajuara për pranimin dhe transferimin e studimeve aksesohen lehtësisht në portalin kryesor të institucionit në internet: <a href="http://www.beder.edu.al">www.beder.edu.al</a>. Gjithashtu, në përfundim të çdo raundi të regjistrimit, KU "Bedër" afishon në mënyrë transparente listen e kandidatëve fitues në platformën zyrtare të menaxhuar nga institucioni. Ndërsa tjetra, këto informacione mund të aksesohen edhe përmes sekretarive të departamenteve, sekretarisë mësimore, ose pranë zyrës së pranimit.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesës së studimeve, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Për çdo vit akademik, institucioni publikon kriteret e pranimit, kuotat e disponueshme për secilin program studimi si dhe procedurat për pranimin e studentëve. Aksesi kryhet lehtësisht nga faqja kryesore e internetit të KU "Bedër".<sup>339</sup> Në përputhje me afatet dhe direktivat e përcaktura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me drejtoret arsimore rjonale, institucioni merr pjesë në panaire dhe workshopë për të prezantuar tek studentët ofertën akademike të tij. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, procedura e pranimit së bashku me kuotat përkatëse për çdo program studimi publikohen edhe në portalin U-Albania, përmes së cilët studentët kanë akses dhe njihen me ofertën akademike të prezantuar nga KU "Bedër".</p> <p>Që nga momenti i regjistrimit të tyre në KU "Bedër", studentët pajisen me llogaritë elektronike për të patur akses në platformën (BIS) nga ku ata mund të aksesojnë në mënyrë të përditësuar përparimin përgjatë kursit të studimit dhe vlerësimin e vazhdueshëm të dijeve. Informacioni mund të merret edhe nëpërmjet zyrës së sekretarisë mësimore.<sup>340</sup> Sa i përket kriterieve dhe procedurave për transferimit, neni 4 i Rregullores së Transferimit të Studimeve parashikon qartë procedurën e transferimit të studimeve nga një institucion i arsimit të lartë në KU "Bedër". Lidhur me transferimet horizontale, studentët që kanë kryer një semestër në një program të studimit të ciklit të parë, apo program studimi të ciklit të dytë mund të aplikojnë pranë Zyrë së Sekretarisë Mësimore në fillim të vitit akademik, brenda afateve të përcaktuara në kalendarin akademik, për t'u transferuar në një program tjeter studimi, brenda të njëjtës njësi kryesore të institucionit. Neni 13 i rregullores, parashikon që studentëve të cilët janë tranferuar në një nga Fakultetet e Universitetit, u jepet diplomë, me kusht që të kenë kryer të paktën dy semestra në KU "Bedër".<sup>341</sup></p>
<b>Kriteri 5.</b> Përpresa fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje	<p>Siq u përmend dhe më lart, procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, së bashku me kuotat e secilit program studimi, dhe kriteret e pranimit dërgojen në ministrinë përkatëse dhe bëhen publike në faqen kryesore të internetit të institucionit. Informacioni gjendet me lehtësi në linkun bashkëngjitur.<sup>342</sup> Programi përcaktion që</p>

<sup>336</sup> <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-19-18/6/151>

<sup>337</sup> Evidencia nr. 58: Vendim për ngritjen e komisionit për përgjedhjen e studentëve fitues për programin Bachelor.

<sup>338</sup> Evidencia nr. 22: Vendim Senati mbi kriteret e pranimit të studentëve.

<sup>339</sup> <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-19-18/6/151>.

<sup>340</sup> Evidencia nr. 57: Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore.

<sup>341</sup> Evidencia nr. 41: Rregullorja e Transferimit të Studimeve, neni 4, 13.

<sup>342</sup> <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-19-18/6/151>.



me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	ndjek afatet e aplikimit dhe regjistrimit në përputhshmëri të plotë me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.								
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret përgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.	Përtej politikave institucionale dhe organizimit si një institucion jo-fitimprurës, KU "Bedér" ka zbatuar kriteret e hartuara nga instancat përkatëse për pranimin e studentëve bazuar në kapacitetet fizike dhe humane që zoteron. Sa u përket kritereve përgjedhjeve të kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara institucioni përcakton për këto kategori kuotat e pranimit në fillim të çdo viti akademik, në përputhje me vendimin e Këshillit të Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit. <sup>343</sup>								
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret përgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	KU "Bedér" me qëllim mbështetjen e diversitetit në programet e studimit të ofruar nga ky IAL parashikon çdo vit edhe kuota për studentë të huaj apo të ardhur nga trevat shqiptare jashtë atdheut. <sup>344</sup>								
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe përgjedhjen e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe përvillimin ekonomik të vendit.	KU "Bedér" i kushton një rëndësi të veçantë edhe ofrimit të bursave për shtresat në nevojë, studentëve me aftësi ndryshe, dhe studentëve të cilët kanë një talent apo kanë fituar medalje, me qëllim rritjen e cilësisë së pranimit në programe me përparësi përvillimin ekonomik të vendit. Kriteret për akordimin e bursave nga institucion, diskutohen në senatin akademik dhe miratohen me vendim të Bordit të Administrimit të Institucionit. <sup>345</sup>  Informacioni lidhur me kategoritë e studentëve të cilët përfitojnë zbritje në tarifat e studimit si pjesë e programit të bursave gjenden lehtësish në website kryesore. <sup>346</sup>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: red; color: white;">Nuk përbushet</td> <td style="background-color: orange; color: white;">Përbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: yellow; color: black;">Përbushet kryesisht</td> <td style="background-color: green; color: white;">Përbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informimi i plotë dhe transparent për studentët dhe publikun bëhet nga institucioni përmes tre mundësive. Informacioni së pari, mund të aksesohet lehtësish në Guidën e Studentit. <sup>347</sup> Së dyti, studentët mund t'i drejtohen sekretarisë mësimore <sup>348</sup> apo koordinatores së departamentit, dhe së fundmi studentët mund t'i drejtohen tek këshilltarët e tyre akademik. Informacioni paraprak në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin parashikohet edhe në rregulloren e ciklit të parë të studimeve dhe provimeve, në rregulloren e programit të studimit, në kontratën e studentit, si dhe në Rregulloren Themelore. <sup>349, 350, 351</sup> Studentët mund t'i ndjekin përparimin e tyre akademik në mënyrë të

<sup>343</sup> Evidenca nr. 66: Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit.

<sup>344</sup> Evidenca nr. 66: Propozim për rishpërndarjen e kuotave për pranimin e studentëve në Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit.

<sup>345</sup> Evidenca nr. 59: Miratimi i llojeve të zbritjeve të tarifave të studimit.

<sup>346</sup> [https://www.beder.edu.al/static/docs/bursat\\_dhe\\_tarfat\\_e\\_studimit\\_2023\\_2024\\_9b40.pdf](https://www.beder.edu.al/static/docs/bursat_dhe_tarfat_e_studimit_2023_2024_9b40.pdf).

<sup>347</sup> Evidenca nr. 28: Guida e Studentit - fq. 19, 22, 25.

<sup>348</sup> Evidenca nr. 57: Performance e Studentit nga Zyra e Sekretarisë Mësimore.

<sup>349</sup> Evidenca nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike - Neni 20, 21.

<sup>350</sup> Evidenca nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë - Neni 5, 16, 17.

<sup>351</sup> Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore - Kreu 12: Neni 92, 93.



	vazhdueshme përmes sistemit të informimit (BIS) ku shikojnë të përditësuara notat, mungesat, syllabuset e secilës lëndë, etj. <sup>352</sup>								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	I gjithë procesi për njohjen dhe transferimin e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme është parashikuar në Rregulloren për transferimin e studimeve. <sup>353</sup> Komisioni i ngritur nga Këshilli i Departamentit bën njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, si dhe vendos për transferimet që kryhen në KU "Bedër". <sup>354</sup> Ky komision informon studentët në lidhje me njohjen e lëndëve dhe procedurave në vijim.								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve Guidën e Studentit <sup>355</sup> e cila përcakton qartë kriteret dhe metodën e vlerësimit të dijeve. Lëndët shpesh vlerësohen nga një kombinim metodash. Metodat e përdorura vendosen nga lektori i lëndës. Disa nga metodat e vlerësimit, të përdoruara nga KU "Bedër" janë: provimet, detyrat e kursit, puna praktike, esse/projekte etj. Studentët në javën e parë të vitit akademik njihen me programet lëndore dhe zërat e vlerësimit të cilat mund të gjinden edhe në faqen publike të departamentit. Nëpërmjet llogarisë email të krijuar nga institucioni, studentët mund t'i aksesojnë në kohë reale këto të dhëna përmes sistemit (BIS). <sup>356</sup> Gjithashtu, përmes sistemit të informimit (BIS), studentët janë të përditësuar me notat dhe pikët e secilës lëndë, pjesëmarrja në leksione dhe seminare, nota mesatare e gjeneruar nga sistemin.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	KU "Bedër" bën publik informacionin rreth provimeve finale dhe mbrojtjes së diplomave në përputhje me Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë. <sup>357</sup> KU "Bedër" po ashtu në funksion të procesit të diplomimit vë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme përmes Manualit të Tezës. <sup>358</sup> Në irregulloren programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (neni 19), parashikon kryerjen e një punimi diplome. <sup>359</sup> Kriteret e kryerjes së punimit, provimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohen nga departamenti përgjegjës për programin e studimit. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor. <sup>360</sup>								
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	KU "Bedër" mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe përmes panaireve të karrierës në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të institucionit. Për më tepër organet kompentente organizative angazhohen me publikimin e katalogjeve, shpërndarjen e broshurave, organizimin e takimeve të drejtpërdrejta dhe marrin pjesë në panaire të ndryshme. <sup>361</sup>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<sup>352</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedér (BIS).

<sup>353</sup> Evidencia nr. 41: Rregullorja për transferimin e studimeve.

<sup>354</sup> Evidencia nr. 103: Vendim i Komisionit për njohjen e krediteve për transferim.

<sup>355</sup> Evidencia nr. 28: Guida e Studentit.

<sup>356</sup> Evidencia nr. 30: Syllabusi i lëndës e-Commerce

<sup>357</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, nen 15.

<sup>358</sup> Evidencia nr. 60: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të pare.

<sup>359</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, nen 19.

<sup>360</sup> Evidencia nr. 29: Kurrikula - Bachelor ne Informatike Ekonomike.

<sup>361</sup> Evidencia nr. 99: Broshura Bachelor në "Informatikë Ekonomike".



**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të tij nxënët dhe mundësitet e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni nëpërmjet ditëve të orientimit <sup>362</sup> ndjek politika mbështetëse dhe informimi për studentët. Secili departament organizon një program orientimi që prezanton studentët me zyrat përkatëse me të cilat do të bashkëveprojnë gjatë gjithë ciklit të programit të studimit. Secili grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Kjo parashikohet në nenin 6 të rregullores së studimeve të ciklit të parë dhe provimeve. <sup>363</sup> Përgjatë ditëve të orientimit, studentët njihen me stafin akademik dhe me atë administrativ, orarin, sistemin (BIS), strukturën e institucionit, kohëzgjatjen dhe organizimin e programit mësimor. Informacionet e listuara më sipër por dhe më tepër ofrohen në mënyrë transparent dhe të përditësuar nga sistemi (BIS) <sup>364</sup> dhe faqja zyrtare e internetit të KU "Bedër".
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në vazhdim të kritereve të përmendura më lart, institucioni vendos në dispozicion të studentëve Sistemin Informativ (BIS) të aksesueshëm nëpërmjet llogarive elektronike të krijuara nga përgjegjësit e "IT" si dhe një dosje fizike që përbën informacion mbi programin e studimit. Në website gjendet Guida e Studentit <sup>365</sup> e cila prezantohet edhe në javën e orientimit, struktura dhe ngarkesa e programit të studimit, modulet dhe lëndët. Për më tepër, nëpërmjet sistemit (BIS) studentët përditësohen mbi lajmërimet e lëndëve përkatëse, informacione të cilat mund t'i marrin dhe pranë zyrës së sekretarisë mësimore. <sup>366</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitet e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	KU "Bedër" ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës pranë Dekanatit të Studentëve për të ofruar mbështetje shtesë dhe për të ndihmuar studentët me këshillimin e karrierës. Secili department, emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rrith procesit të kërkimit të punës, hartimin dhe përpunimin e Jetëshkrimit (CV) dhe parapërgatitjen për intervistën e punës. <sup>367</sup> Gjithashtu, këshilltari i karrierës studion mundësi të ndryshme punësimi për të gjithë studentët që do të diplomohen në programin "Bachelor", si dhe organizon aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve të institucionit me studentët edhe pas përfundimit të studimeve. <sup>368</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjërë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni vendos në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik mjedise të pështatshme dhe sinjalistikë të përditësuar për realizimin e mësimdhënieς dhe mësimnxënies në mënyrë eficiente. Sa për më lart, KU "Bedër" zoteron hapësira të mjaftueshme si: klasa, zyra, laboratori kompjuterik, bibliotekë, dhe mjedise të mirëpasisura me aparate të teknologjisë së informacionit në mbështetje të programit të studimeve. <sup>369</sup> Për secilin program studimi, institucioni disponon kompjuterë ne laboratorët e teknologjisë së informacionit, pajisur me programe softuerike statistikore, dhe gjuhësore të cilë bëjnë të mundur realizimin e procesit mësimorës sipas specifikave lëndore. Ambjentet mësimore janë të pajisura me tabelë interaktivë (smart board).

<sup>362</sup> Evidencia nr. 68: Programi i ditëve të Orientimit të studentëve 2023-2024.

<sup>363</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.

<sup>364</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).

<sup>365</sup> Evidencia nr. 28: Guida e Studentit.

<sup>366</sup> Evidencia nr. 18: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.

<sup>367</sup> <https://www.facebook.com/photo?fbid=765094565658987&set=a.484044633763983>

<sup>368</sup> Evidencia nr. 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës.

<sup>369</sup> Shtoica: Tabela nr. 16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë.



	<p>kompjutera, projektorë, dhe karrige ortopedike çka është në sinkron me metodat kontemporane të mësimdhënies.</p> <p>Me qëllim informimin e plotë të studentëve mbi programin që ndjekin, kurrikulen përkatëse, personelin akademik, dhe infrastrukturën e vënë në dispozicion të tyre, institucioni organizon në fillim të viti akademik takimet orientuese.<sup>370</sup> Fokusi kryesor i këtyre takimeve janë studentët e viti të parë, të cilët njihen konkretisht me njësinë bazë dhe lektorët që drejtajojnë programet e tyre të studimit, kurrikulen, infrastrukturën fizike të institucionit, sistemin e automatizuar (BIS) por edhe me zyrat përkatëse të sekretarës.</p> <p>Seancat e orientimit kontribuojnë në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në ditët e informimit prezent janë këshilltarët akademikë dhe koordinatorët e secilit program, të cilët sigurojnë mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe mësimnxnës në terma afatgjatë. Së fundmi, me qëllim kryesor për të garantuar një komunikim sa më efektiv midis institucionit dhe studentit, ndiqen politika mbështetëse, ku secili grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltar akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore.<sup>371</sup></p>								
<b>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësish i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</b>	<p>Sikurse është trajtuar edhe në kapitullin III, në momentin e regjistrimit, secili student pajiset me një llogari personale elektronike. Gjithashtu, KU "Bedër", shfrytëzon si kanal komunikimi edhe faqen kryesore të internetit, por edhe llogaritë në rrjetet sociale për lajme dhe njoftimet periodike. Për t'u siguruar që informacionet në lidhje me programet e studimit janë plotësish dhe lehtësish të askesueshme nga studentët, institucioni vë në dispozicion për këtë qëllim edhe zyrën e protokollit dhe korrespondencës.</p> <p>Gjithashtu, studentët e regjistruar informohen në kohë reale përmes sistemit të automatizuar (BIS) i cili është i aksesueshëm edhe në distancë.<sup>372</sup></p>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</b>	Zyra e sekretarisë mësimore pranë KU "Bedër" ndjek nga afér regjistrimin e të gjithë studentëve, duke krijuar dosjen individuale për secilin prej tyre. Nga ana tjetër, zyra e sekretarisë mësimore, ndërsa funksionet e saj ka edhe përpunimin e të dhënave në formë statistikore të të diplomuarve. Kjo parashikohet në rregulloren e zyrës së sekretarisë mësimore, nen 3 i saj. <sup>373</sup>
<b>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të viti akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</b>	Zyra e sekretarisë mësimore, pranë KU "Bedër", disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të cilin të parë, çregjistrimet, diplomimet dhe mospërfundimin me sukses të viti akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve duke i raportuar këto statistika te instituciat përgatitese apo dhe tek njësitet e tjera, bazuar në kërkesa specifike. Statistika vjetore të studentëve disponohen nga Zyra e Sekretarës Mësimore, dhe përbajnjë informacion në lidhje me regjistrimin në një nga programet e studimit, të

<sup>370</sup> Evidencia nr. 68: Programi i ditëve të Orientimit 2023-20234.

<sup>371</sup> Evidencia nr. 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës.

<sup>372</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedör (BIS).

<sup>373</sup> Evidencia nr. 18: Rregullorja e Zyrës se Sekretaries Mësimore, Neni 3, pika 3.

	<p>dhëna deri në përfundim të studimeve ose tërheqje nga programi përpara përfundimit të tij.<sup>374</sup></p>								
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigura dhe lehtësish të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në mënyrë digitale nga sistemi i informacionit BIS. Të dhënat nga dosjet individuale që gjenden pranë Zyrës së Sekretarisë Mësimore, analizohen nga kjo njësi dhe gjenerohen në sistemin BIS, informacione të cilat mund t'i aksesojë njësia në fjalë, këshilltari akademik dhe persona të tjera të autorizuar.<sup>375, 376, 377</sup></p> <p>Të dhënat në regjistra janë konfidenciale dhe lehtësish të verifikueshme nga personat e autorizuar, në përputhje me aktet normative të ruajtes së të dhënave pësonale të KU "Bedér".<sup>378</sup> I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në sistemin BIS dhe bëhet i aksesueshëm për studentin përmes numrit të tij të matrikullimit.<sup>379</sup></p>								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariëtë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<p>Institucioni, kontrollon periodikisht gjithë njësitë përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.<sup>380</sup></p> <p>Njësitë menaxhuese njoftohen për periudhën e auditimit të brendshëm, përcaktohet dita që i nënshtron kontrollit dhe në fund u dërgohet një raport mbi rezultatin dhe rekomandimet e lëna.</p>								
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Çdo njësi bazë, në fund të vitit akademik harton reportin vjetor<sup>381</sup> në të cilin paraqiten të dhëna statistikore mbi studentët e regjistruar në programet e studimit. Ky rapport është gjithashtu pjesë e rapportit institucional<sup>382</sup> i cili dorëzohet pranë Ministrisë së Arsimit.</p> <p>Në nivel departamenti organizohen një sërë aktivitete me të fluar përfaqësues të ndryshëm të kompanive dhe bizneseve, sikurse dhe vizita studimore në këto institucione, me qëllim vendosjen e një linje të vazhdueshme komunikimi deri në punësimin e studentëve. Gjithashtu, në të njëjtën linjë kemi pjesëmarrje të ndryshme në aktivitete me shumë palë interes, dhe panaire të ndryshme pune, me qëllim punësimin e studentëve. Në mbështetje të këtij qëllimi secili vit ka nga një këshilltarë akademik, funksioni kryesor i të cilit është të asistojë studentët gjatë gjithë proceseve të studimeve Bachelor, duke filluar që nga përzgjedhja e lëndëve, plotësimi i formularëve, etj.<sup>383</sup> Në shërbim të punësimit të tyre, secili department ka nga një përfaqësues pranë Zyrës së Karrierës i cili merret drejtpërdrejt me vendosjen e studentëve në praktika pune, rritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të departamentit, dhe mundësishet deri në punësimin e studentëve. Përfaqësuesi i departamentit shërben si urë lidhëse midis departamentit dhe Zyrës së Karrierës dhe të Diplomuarve, për të arritur punësimin e studentëve, duke mundësuar kështu ofrimin e një shërbimi të plotë përsa i përket menaxhimit të karrierës, njoftimeve periodikë të punësimit si dhe ndihmë konkrete në plotësimin e dokumentacionit për aplikime dhe përgatitjen e CV-ve.<sup>384</sup></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						

<sup>374</sup> Shtoja: Tabela nr. 21: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.

<sup>375</sup> Evidencia nr. 18 : Rregulllore e Sekretarisë Mësimore.

<sup>376</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzuesi i Sistemit Informativ BIS.

<sup>377</sup> Evidencia nr. 42 : Miratimi i Udhëzuezit për Këshilltarin Akademik.

<sup>378</sup> Evidencia nr. 89: Rregullorja përmbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

<sup>379</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzuesi i Sistemit Informativ BIS.


<sup>380</sup> Evidencia nr. 80: Raport për auditimin periodik.

<sup>381</sup> Evidencia nr. 67: Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit 2022-2023.

<sup>382</sup> Evidencia nr. 13: Raporti Vjetor Institucional.

<sup>383</sup> Evidencia nr. 10: Rregullorja e Organizimit Akademik, Neni 18.

<sup>384</sup> Evidencia nr. 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës



**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Në Statutin e KU "Bedër"<sup>385</sup> specifikohet përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, sipas të cilës studentët janë të përfshirë në Senat Akademik (neni 10) dhe NJSBC (neni 28). Po ashtu, studentët janë të përfshirë edhe në Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë<sup>386 387</sup> dhe Këshillin e Departamentit<sup>388</sup>.</p> <p>Gjithashtu, KU "Bedër" me anë të rregullores së organizimit administrativ parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Këshilli studentor përbëhet nga përfaqësues të studentëve. Kryetari i këshillit studentor merr pjese në organet vendimmarrëse të institucionit si përfaqësues i studentëve.<sup>389</sup> Një njësi kyçë në garantimin dhe vazhdueshmërinë e angazhimit të studentëve është Dekanati i Studentëve, njësi e cila së bashku me zyrat përbërëse ndihmojnë dhe përfshijnë studentët që nga momenti i regjistrimit e deri në përfundim të studimeve duke ruajtur kontaktet edhe pas diplomimit të tyre. Dekanati i Studentëve realizon detyrat e mësipërme me anë të këshillimit, realizimit të aktiviteteve sociale, mbrojtjen e të drejtave të studentëve, mundësimin e praktikave profesionale dhe orientimin drejt tregut të punës.</p> <p>Dekanati i Studentëve mundëson angazhimin e studentëve që dëshirojnë në një numër klubesh, ku studentët jo vetëm përfshihen në nisma sociale por edhe gjunjë mundësinë të zhvillojnë pasionet apo/dhe të përmirësojnë talentet e tyre.<sup>390 391</sup> Për më tepër, një rol të veçantë në institucion ka edhe Këshilli Studentor i cili përbëhet nga senatorët e secilit vit studimi, të përzgjedhur nga vetë studentët të cilët sipas rasti bëhen pjesë aktive e vendim-marrjes institucionale.<sup>392</sup></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësish të verifikueshme e të matshme.	<p>Në KU "Bedër", studentët janë pjesë e mbledhjeve të këshillave të njësive bazë<sup>393</sup>, si dhe pjesë e grupeve të punës në proceset e akreditimit.<sup>394</sup> Studentët e KU "Bedër" marrin pjesë aktive në këshillim dhe vlerësim nëpërmjet anketës së vlerësimit të studentit ndaj institucionit<sup>395</sup> dhe ndaj stafit akademik dhe lëndës.<sup>396</sup></p>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në	Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit përbën një ndër pikat kryesore të misionit të KU "Bedër". Në pikën 3.3.1 të Politikës së KU "Bedër" për përmirësimin

<sup>385</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i Kolegit Universitar Bedër, neni 10, 28.

<sup>386</sup> Evidencia nr. 16: Rregullorja e funksionimit të komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit, neni 10.

<sup>387</sup> Evidencia nr. 97 : Vendimi për emerimin e Antarëve te Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve dhe Cilësisë.

<sup>388</sup> Evidencia nr. 71: Studentët Përfaqësues në Mbledhjet e Këshillit të Departamentit.

<sup>389</sup> Evidencia nr. 11: Rregullorja mbi organizimin administrativ, neni 45.

<sup>390</sup> Evidencia nr. 53: Udhëzim mbi klubet Studentore.

<sup>391</sup> Evidencia nr. 98: Raporti vjetor i klubeve

<sup>392</sup> Evidencia nr. 106: Rezultatet e zgjedhjeve studentore, viti akademik 2023-2024.

<sup>393</sup> Evidencia nr. 71: Studentët përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Departamentit.

<sup>394</sup> Evidencia nr. 107: Vendim i Senatit Akademik për miratimin e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, programi Bachelor në "Informatikë Ekonomike"

<sup>395</sup> Evidencia nr. 50: Anketë vlerësimi i studentëve për institucionit.

<sup>396</sup> Evidencia nr. 34: Anketa e studentit ndaj lëndës



procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	e programit të studimit <sup>397</sup> : "Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar realizohet në semestrin e fundit me studentët në prag diplomimi. <sup>398</sup> Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga studentët e diplomuar realizohet pas diplomimit <sup>399</sup> " Realizimi i anketës, mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre, kryhen nga departamenti që ofron programin e studimit. Përbajtja e anketës përqendrohet kryesisht në vlerësimin e kurrikulës, programit dhe syllabuseve dhe ka për qëllim marjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit.								
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmérinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njojur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit e cila është e përcaktuar në Rregulloren Themelore, ku parashikohet se studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin e provimit, neni 102 <sup>400</sup> edhe në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të parë të Studimeve, neni 24 <sup>401</sup> . Po ashtu, rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", neni 28 shpjegon qartë se "Nëse studenti/ja ka pretendime ose ankesa kundrejt vlerësimit dhe rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai/ajo ka të drejtë që brenda një javë nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim pranë zyrës së sekretarisë mësimore". <sup>402</sup> Në Guidën e studentit përcaktohet se "Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një javë nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim pranë Zyrës së Sekretarisë Mësimore. Animi shqyrtohet nga një komision i cili ngrihet me vendim të këshillit të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre anëtarësh. Këshilli cakton si anëtarë të komisionit lektorë të cilët janë sa më pranë specialitetit dhe që kanë ekspertizën e duhur në fushën e studimit në fjalë. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim". <sup>403</sup>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="background-color: red; color: white;">Nuk përbushet</th> <th style="background-color: orange; color: white;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: yellow; color: black;">Përbushet kryesisht</th> <th style="background-color: green; color: white;">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: right;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësish të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p style="text-align: center;">KU "Bedër" në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit<sup>404</sup> gjithë informacionin e nevojshëm për përbajtjen e programeve të studimit që ofron si dhe Guidën e Studentit për çdo çështje që lidhet me procesin mësimor.<sup>405</sup></p> <p>Përveç faqes zyrtare, studentët e KU "Bedër" informohen dhe më anëtë zyrave të institucionit të parashikuara në rregulloren e organizmit administrativë, si Zyra e Sekretarisë Mësimore, Zyra e Regjistrimeve, Zyra e Planifikimit te Kurierës, dhe</p>

<sup>397</sup> Evidencia nr. 46: Politika për Përmirësimin e programeve të studimit, pika 3.3.1.

<sup>398</sup> Evidencia nr. 47: Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit.

<sup>399</sup> Evidencia nr. 4: Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit.

<sup>400</sup> Evidencia nr. 3: Rregullorja Themelore, neni 102.

<sup>401</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 24.

<sup>402</sup> Evidencia nr. 35: Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike - Neni 28.

<sup>403</sup> Evidencia nr. 28: Guida e studentit (Apelimet).

<sup>404</sup> <https://ecobus.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-informatike-ekonomike-13-3/675/676>.

<sup>405</sup> Evidencia nr. 28: Guida e Studentit.



	<p>Zyra e të Diplomuarve në varësi të Dekanatit të Studentëve, sekretarive mësimore të njësive bazë si dhe këshilltarëve akademik.<sup>406</sup> Asistimi i këtyre zyrave është i vazhdueshëm përgjatë gjithë vitit akademik. Sistemi BIS gjithashtu, vlen si një formë informimi ku studentët ndjekin performancën e tyre në lëndët e semestrit përkatës dhe rezultatet deri në diplomimin e tyre.<sup>407</sup> Përsa i përket informacioneve që lidhen drejt për drejt me lëndën, studentët njihen me syllabuset e secilës lëndë gjatë javës së parë të vitit akademik dhe në vazhdimësi komunikimi bëhet nëpërmjet emailit institucional.<sup>408</sup></p> <p>Paralelisht me mënyrat e rregulluar të informimit, studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme përmes maileve zytar të hapur në llogari të KU "Beder".</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Në fillim të vitit akademik, Dekanati i Studentëve në bashkëpunim me Zyrat Administrative organizon Ditët e Orientimit për studentët e vitit të parë duke i orientuar ata për procese të ndryshme dhe njësítë ku këto procese ndiqen.<sup>409</sup> Për çdo program studimi me vendim të këshillit të departamentit përcaktohet Koordinatori i Programit për vitin akademik, i cili është përgjegjës për mbarëvajten e gjithë proceseve gjatë gjithë vitit.<sup>410</sup></p> <p>Në vijim atyre ju përcaktohet një Këshilltar Akademik i cili ndjek të gjitha proceset akademike dhe administrative që lidhen me studentët.<sup>411</sup> Këshilltari i Karrierës gjithashtu luan një rol të rëndësishëm duke i ndjekur studentët deri në punësimin e tyre.<sup>412</sup></p> <p>Në të njëjtën mënyrë studentët e programit të studimit asistohen në lidhje me mundësitet e mobilitetit të paraqitura përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka në çështje si, procedurat e aplikimit, përzgjedhja e lëndëve në institucionin pritës, etj., përmes Asistentit pranë Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare.<sup>413</sup></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, e parashikuar kjo në rregulloren mbi organizimin administrative. <sup>414</sup> Zyra e Planifikimit të Karrierës në KU "Beder" ka si funksion orientimin dhe këshillimin e studentëve drejt praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit në tregun e punës. Çdo departament emeron një këshilltar karriere pranë zyrës së karrierës, i cili në bashkëpunim me përgjegjësin e kësaj zyre, informojnë studentët për mundësitet e trajnimeve, seminareve dhe aktiviteteve me karakter të zhvillimit profesional të zhvilluara brenda dhe jashtë institucionit. <sup>415</sup> <p>Përveç orientimit, një rol i rëndësishëm i zyrës së planifikimit të karrierës është edhe asistimi gjatë procesit të zhvillimit të praktikës profesionale. Çdo program Bachelor përmban një lëndë të detyrueshme "Praktikë Profesionale/Mësimore" në kurrikul. Studentët marrin informacion nga zyra si dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për praktikë pranë institucioneve të tjera.<sup>416</sup></p>	

<sup>406</sup> Evidencia nr. 11: Rregullorja mbi organizimin administrative.

<sup>407</sup> Evidencia nr. 24: Udhëzues i Sistemit Informativ Beder (BIS).

<sup>408</sup> Evidencia nr. 78: Shembull syllabusi - Programim në web.

<sup>409</sup> Evidencia nr. 68: Programi i ditëve të orientimit të studentëve 2034-24.

<sup>410</sup> Evidencia nr. 51: Vendimi i Këshillit të Departamentit për përcaktimin e koordinatorit të programit të studimit.

<sup>411</sup> Evidencia nr. 74: Vendimi i Këshillit të Departamentit për përcaktimin e këshilltarëve akademik.

<sup>412</sup> Evidencia nr. 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës

<sup>413</sup> Evidencia nr. 82: Vendimi i Këshillit të Departamentit për përcaktimin e asistenit pranë Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

<sup>414</sup> Evidencia nr. 11: Rregullorja mbi organizimin administrativë, nen 41.

<sup>415</sup> Evidencia nr. 61: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës.

<sup>416</sup> Evidencia nr. 55: Procedurë për praktikën profesionale.



<b>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës</b> ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në strukturën organizative, në varësi të Dekanit të Studentëve është ngritur dhe Zyra e të Diplomuarve <sup>417, 418</sup> , e cila mban lidhje me të diplomuarit, punësimin e tyre, etj. <sup>419</sup> Në këtë pikë, konkretisht në programin Bachelor në "Informatikë Ekonomike", nuk ka një brez të diplomuarisht të gjurmuar përsa i përket punësimit apo diplomimit pasi duhet të theksojmë se këtë vit diplomon brezin e parë të studentëve.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<sup>417</sup> Evidencia nr. 11: Rregullorja mbi organizimin administrativ, nen 44

<sup>418</sup> <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/zyra-e-te-diplomuareve-17-10/424/579>

<sup>419</sup> Evidencia nr. 96: Raport i Zyrës së të diplomuarve



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	KU "Bedër" ka hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, të cilat përfshijnë elementë të vlerësimit, angazhimit të studentëve, trajtimit gjithëpërfshirës e të barabartë, etj. <sup>420, 421</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. KU Bedër në çdo semestër organizon anketa me studentët për vlerësimin e stafit dhe lëndës. Gjithashtu stafi plotëson një formular vetëvlerësimi në fund të së cilit bëhet dhe vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit për çdo lektor <sup>422</sup> . Stafi akademik vlerësohet edhe me anë të formularit për vlerësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. <sup>423</sup> Gjithashtu bëhet edhe një vlerësim në rang departamenti dhe fakulteti. <sup>424</sup>	Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. KU Bedër në çdo semestër organizon anketa me studentët për vlerësimin e stafit dhe lëndës. Gjithashtu stafi plotëson një formular vetëvlerësimi në fund të së cilit bëhet dhe vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit për çdo lektor <sup>422</sup> . Stafi akademik vlerësohet edhe me anë të formularit për vlerësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. <sup>423</sup> Gjithashtu bëhet edhe një vlerësim në rang departamenti dhe fakulteti. <sup>424</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Studentët janë të përfshirë në vlerësimin e metodave të mësimdhënies me anë të anketës semestrale për pedagogun dhe lëndën. Kjo anketë përfshin rubrika si vlerësimin e metodave të mësimdhënësia, vlerësimin e dijeve, përgatitjen e pedagogut, etj. Të gjithë studentëve u garantohet e drejta për të ankimuar notën në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. Kjo bazohet në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë dhe formularin e ankimimeve. <sup>425, 426</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit të lëndës dhe pedagogut i përcillen nga rektori i pergjegjësve të departamenteve përkatëse, e më pas pedagogut të lëndës. Gjithashtu, në bazë të raporteve të vetëvlerësimit i përcillet dekanatit dhe rektoratit vlerësimi i njësisë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në rezultatet e dala nga vlerësimet e stafit akademik KU "Bedër" ka shpallur listën e stafit me performancën më të lartë për të dy fakultetet e tij. Me anë të kësaj, KU "Bedër" promovon praktikat më të mira dhe nxit personelin akademik për përmirësimin e mësimdhënies.
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht

<sup>420</sup> Evidencia nr. 102: Udhëzues mbi mësimdhënien inovative.

<sup>421</sup> Evidencia nr. 36: Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë.

<sup>422</sup> Evidencia nr. 39: Formulari i vlerësimit për stafin akademik.

<sup>423</sup> Evidencia nr. 48: Formulari i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies.

<sup>424</sup> Evidencia nr. 84: Raporti përbledhës i vetëvlerësimit për stafin akademik.

<sup>425</sup> Evidencia nr. 34: Anketa e studentit ndaj lëndës

<sup>426</sup> Evidencia nr. 6: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, Neni 25.



**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë hartron dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në KU "Bedër" kryhet me anë të këtyre strukturave: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Përherershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Komisioni i Përherershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës. Struktura dhe funksionimi i tyre janë të specifikuara në Statutin e KU "Bedër", në rregulloren e NJSBC, rregulloret e komisioneve, dhe në procedurën për zhvillimin e kurrikulës, në përshtatshmëri të plotë me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore <sup>427 428 429 430 431</sup> . Gjithashtu janë hartuar Politika e Sigurimit të Cilësisë dhe Politika e Përmirësimit të Programeve të studimit <sup>432, 433, 434, 435</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	KU "Bedër" është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e studentëve, sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për verifikimin periodik të cilësisë dhe përmirësimin e saj janë krijuar strukturat e përmendura më lart. Në përbërje të NJSBC dhe Komisionit të Përherershëm të Cilësisë ka nga pesë anëtarë: tre pedagogë të brendshëm, një student dhe një ekspert i jashtëm Përmirësimi dhe sigurimi i vazhdueshëm i cilësisë zbatohet si pjesë e strategjisë institucionale.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë në KU "Bedër" realizohet me anë të sigurimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë. KU "Bedër" ka kaluar me sukses 3 akreditime institucionale, në vitin 2013 nga APAAL, në vitin 2017 nga Agjensia Britanike e Akreditimit "Quality Assurance Agency", në bashkëpunim me ASCAL dhe të tretin në vitin 2021. Institucioni aplikon brenda afateve edhe për akreditimin e programeve që ofron dhe realizon këtë proces nën koordinimin e NJSBC-së. Raportet e vlerësimeve të brendshme, të jashtme dhe vlerësimet përfundimtare janë bërë publike në faqen e institucionit. <sup>436</sup> Institucioni ka gjithashtu edhe një rregullore të anketave dhe të vlerësimeve, e cila rregullon procesin e mbledhjes së të dhënavë dhe të përdorimit të tyre në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo rregullore parashikon marjen e informacionit nga anketat e plotësuara nga ana e stafit akademik, stafit administrativ dhe nga studentët, si dhe analizimin e tij me qëllim rregullimin e procesit të vlerësimit të arsimimit, mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe çdo shërbimi të ofruar nga KU "Bedër" <sup>437</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënien dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime	KU "Bedër" kryen periodikisht vlerësimin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor me anë të treguesve të qartë dhe të matshëm, siç parashikohet në rregulloren e anketave dhe vlerësimeve. Ky vlerësim realizohet me anë të formularit të vetëvlerësimit për stafin akademik, që plotësohet çdo fund viti akademik nga çdo anëtar i personelit akademik. Ndërsa tjetra, formulari përmban të dhëna për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Vlerësimi i mësimdhënies realizohet edhe me anë të pyetësorit të studentëve për pedagogun dhe iku i tij në çdo fund semestri.

<sup>427</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i KU "Bedër", Kreu VIII, nen 28.

<sup>428</sup> Evidencia nr. 17: Rregullore për Funksionimin dhe organizimin e NJSBC.

<sup>429</sup> Evidencia nr. 16: Rregullorja e fuknsionimit të komisionit të përherershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.

<sup>430</sup> Evidencia nr. 19: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore, Neni 5.

<sup>431</sup> Evidencia nr. 38: Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulave

<sup>432</sup> Shtoja: Tabela nr. 24: Të dhëna për anëtarët e NJSBC.

<sup>433</sup> Evidencia nr. 15: Plani Strategjik Institucional 2018-2023.

<sup>434</sup> Evidencia nr. 52: Politika e cilësisë.

<sup>435</sup> Evidencia nr. 46: Politika për Përmirësimin e programeve të studimit.

<sup>436</sup> <https://iac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions>.

<sup>437</sup> Evidencia nr. 32: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve, nen 3.



nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	Vlerësimi i të dhënave nga të dy instrumentet realizohet në nivel njësie bazë dhe diskutohen mangësitë dhe nevojat në nivel individual dhe njësie duke bërë propozime dhe marrje të masave përkatëse për përmirësim.								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="background-color: red; color: white; text-align: center;">Nuk përbushet</th> <th style="background-color: orange; color: white; text-align: center;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: yellow; color: white; text-align: center;">Përbushet kryesisht</th> <th style="background-color: green; color: white; text-align: center;">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;"></td> <td style="text-align: center;"></td> <td style="text-align: center;"></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

### **Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniti.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në kuadër të veprimitarive që i shërbejnë akreditimit të programeve të studimit, KU “Bedër” përdor procese formale të miratimit, shqyrtimit dhe mbikëqyrjes së tyre. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit kryhet në bazë departamenti sipas politikës për përmirësimin e programeve të studimit. Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore propozohen nga njësisë bazë, duke kaluar në njësisë kryesore dhe më pas në Senat. Procesi i ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e zyrës së zhvillimit të kurrikulave sipas procedures përkatëse. Në kuadër të vlerësimit të jashtëm, rezultatet dokumentohen dhe u bëhen të ditura njësive bazë dhe vendimmarrëse, dhe pas evidentimit të mangësive hartohet plani i masave për përmirësim <sup>438</sup> . Rezultatet janë të dokumentuara dhe u bëhen të ditura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshmë, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm shoqërohen me plane veprimi ku parashikohen rezultatet e vlerësimit, masat që do të ndërmerrin për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë dhe rezultatet e pritshmë. Në këto plane veprimi gjithashtu caktohen njësítë përgjegjëse për ndjekjen e çështjes dhe periudha kohore e zbatimit. KU “Bedër” publikon rezultatet e vlerësimit të aktorëve të ndryshëm brenda institucionit (studentë, personel akademik dhe administrativ) në faqen e internetit të tij. Përsa u përket rezultateve të pritshmë, KU “Bedër” ka bërë publik planin strategik për periudhën 2018-2023. KU “Bedër” synon ndërgjegjësimin e personelit të tij dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Për këtë arsy, vazhdimisht realizohen takime orientuese dhe informuese. <sup>439</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejtë, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënieve, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë	Në kuadër të vlerësimit të realizimit dhe cilësisë së programit të studimit KU “Bedër” përdor mënyra të drejtpërdrejtë të vlerësimit të mësimdhënieve, siç janë vlerësimi me notë për detyra dhe projekte, vlerësimi me pikë për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në auditorë. <ul style="list-style-type: none"> <li>● Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor;</li> <li>● Vlerësime me notë dhe me pikë;</li> <li>● Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët;</li> <li>● Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> </ul>

<sup>438</sup> Evidencia nr. 115: Plan i masave për plotësimin e rekomandimeve të BA për institucionin.

439 <https://qac.beder.edu.al/activities>

kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi të studentëve nga njëri-tjetri për nivelin dhe formën e angazhimit të tyre në punë e projekte të realizuara në grup;</li> <li>• Vlerësimi për testime ndërmjetëse të semestrit përkatës;</li> <li>• Vlerësimi për testime finale në përfundim të semestrit.</li> </ul> <p>Gjithashtu, është miratuar fomulari i vlerësimit të vazdueshëm, i cili përfshin elementë si, syllabusi, metodat e mësimdhënies, vlerësim të detyrave dhe projekteve, etj.</p>								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfshira nga ky program.	<p>KU "Bedër" përdor metoda të tërthorta për vlerësimin e programit të studimit si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës e cila plotësohet në fund të çdo semestri dhe studentët japid mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe lëndën. Në të përfshihen aspekte si përbajtja e lëndës, mësimdhënia dhe të nxënët, mënyra e vlerësimit, njohja me syllabusin, etj.</li> <li>2) Anketa vjetore e kënaqësisë së studentit ndaj institucionit ku vlerësohen të gjitha shërbimet e ofruara dhe merren edhe rekomandime nga studentët për këto shërbime.</li> <li>3) Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit akademik ndaj institucionit, ku merret vlerësimi dhe rekomandimet e stafit për shërbimet e ofruara</li> <li>4) Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit administrativ ndaj institucionit ku merren vlerësimi dhe rekomandimet e stafit për shërbimet e ofruara në institucion.</li> <li>5) Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit</li> <li>6) Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit. Në bazë të vlerësimeve dhe rekomandimeve merren masa për përmirësimin e shërbimeve dhe programit të studimit <sup>440 441 442 443 444</sup>.</li> </ol>								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazduhar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Sipas statutit të KU "Bedër", Senati është organ kolegjial që vlerëson dhe garanton cilësinë e programeve të studimit, rektori, dekanët dhe përfaqësues të asamblesë së fakulteteve janë pjesë e senatit. Gjithashtu Senati ngre komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë si dhe miraton zgjedhjen anëtarëve të NJSBC, si dy organe përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në KU "Bedër". Në të dyja këto struktura është siguruar përfaqësimi i stafit akademit nga të dy fakultet, i studentëve dhe i aktorëve të jashtëm. Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë realizohet edhe me anë të përfaqësimit të tyre në mbledhjet e departamentit që ofron programin e studimit si dhe në mbledhjet e këshillit studentor. Stafi i Kolegjit Universitar është kolektivisht përgjegjës për ruajtjen e standardeve akademike.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e	<p>Përgjegjësitet e dy strukturave të sigurimit të cilësisë NJSBC, the komision i përhershëm për garantimin e cilësisë, janë të parashikuar në rrugën e përkatesë. Gjithashtu çdo njësi, individ dhe student është përgjegjës për zhvillimin e çdo deti dhe përgjegjësie në varësi të pozicionit që ka në KU "Bedër".</p>

<sup>440</sup> Evidencia nr. 47: Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit.

<sup>441</sup> Evidencia nr. 34: Anketa e studentit ndaj lëndës.

<sup>442</sup> Evidencia nr. 50: Anketë vlerësimi i studenteve per institucionin.

<sup>443</sup> Evidencia nr. 31: Anketa e stafit akademik dhe stafit administrativ.

<sup>444</sup> Evidencia nr. 90: Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit.

<sup>445</sup> Evidencia nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër. neni 89-90



brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë institucionale është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Këto struktura kryejnë dhe sigurojnë realizimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.								
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantojet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në analizat vjetore dhe seancat trajnuese mbi mbarëvajtjen e institucionit në fillim viti marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbijnë përvojat dhe jepin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantojet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. KU "Bedër" synon ndërgjegjësimin e personelit të tij dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Stafi akademik, administrativ dhe studentët bëhen pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm të programit.								
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shhangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe kryesisht Senati akademik e ka përdetyrë të garantojë respektimin e integritetit të të gjithë aktorëve të përfshirë në vlerësiin e cilësisë dhe të evitojë çdo lloj pabarazie apo diskriminimi ndaj të gjithë studentëve apo stafit akademik. Aktivizimi i personelit dhe studentëve respekton integritetin. Një metodë e rëndësishme përfshirë përmirësuar punët në njësitë kryesore, bazë dhe administrative është edhe organizimi i prezantimeve të hapura të raporteve vjetore të vetëvlerësimit të përgatitura nga ato. Në këto analiza vjetore marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbijnë përvojat dhe jepin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve të caktuara. Proseset ciklike të vlerësimit respektojnë integritetin akademik shhangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Në funksion të sigurimit të barazisë, KU "Bedër" ka miratuar edhe "Politikën për Barazinë Gjinore, Mundësi të Barabarta dhe Diversitet". <sup>446</sup>								
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të jepin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Institucioni përfshin në sigurimin e cilësisë aktorë të jashtëm nëpërmjet strukturave përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë. Komisioni i Përhershëm dhe NJSBC-ja kanë në përbërjen e tyre një anëtar/ekspert të jashtëm. KU "Bedër" organizon takime të vazhdueshme me profesionistë të fushave të programeve që ofron të cilët krahas ekspertizës informojnë edhe me dinamikat e tregut të punës me qëllim përcjelljen e tyre përfshirë ndryshime në programin përkatës. Edhe vlerësimi i brendshëm i programit përfshin përfaqësues të industrisë dhe të diplomuarve, të cilët jepin vlerësimë dhe mendime në lidhje me nevojat apo efikasitetin e njohurive të marra në program. Kjo përfshirje shprehet në politikën përfshirë përmirësimin e programeve të studimit, e cila e bën atë të detyrueshme.								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përfshirë programeve të studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshirë programin	Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë e organizuar kuadër të përmirësimit të cilësisë të programit të studimit janë transparente dhe të akcesueshme

<sup>446</sup> Evidencia nr. 77: Politika e KU "Bedër" për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet

e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	për të gjithë të interesuarit dhe studentët në faqen e sigurimit të cilësisë. <sup>447</sup> Studentët njihen me aktivitet që kryhen në kuadër të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, njoftohen me anë të emailit për të gjitha aktivitet dhe përfshihen në to.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	KU "Bedér" bën publike në faqen e internetit të gjitha rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe duke zbatuar legjislacionin në fuqi për të dhënat personale. Raportet e brendashme <sup>448</sup> , Raportet e jashtme <sup>449</sup> , Vendimet e BA. <sup>450</sup>			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	KU "Bedér" dhe njësitë bazë për programin e studimit rishikojnë vlerësimet e raporteve të jashtme dhe përgatitin planveprimin për përbushjen e rekomandimeve me qëllim plotësimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe të institucionit. <sup>451</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimitarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Informacioni i marrë nga instrumentet e ndryshëm për matjen dhe monitorimin e cilësisë janë pjesë e raportimeve të ndryshme periodike që bëjnë njësitë kryesore dhe bazë respektive. Raportet për monitorimin e cilësisë shpërndahen me stafin akademik dhe diskutohen për përmirësim të mëtejshëm të programeve. Varësish këtyre rezultateve, bëhet një shpërndarje e çështjeve që kërkojnë përmirësim ose zhvillim të mëtejshëm, sipas zyrave përkatëse dhe bëhet ndjekje e zbatimit të tyre. Vlejnë për t'u përmendur këtu, monitorimi i zbatimit të plan-veprimeve të hartuara në kuadër të rekomandimeve të dala nga vlerësimet e jashtme, apo nga akreditimi i programeve të studimit, si dhe rishikimi i dokumentacionit me qëllim përmirësimin e cilësisë në vijim të auditimit të brendshëm që zhvillohet në institucion.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimitari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, NJSBC-ja organizon seanca informuese me studentët dhe personelin e programeve të studimit me qëllimin ndërgjegjësimin e tyre përfshirje aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit me anë të plotësimit të anketave e formularëve përkatëse, por edhe me anë të sugjerimeve. Stafi akademik dhe studentët informohen për rëndësinë që i kushtohet sigurimit të cilësisë edhe në guidat përkatëse. Gjithashtu, si personeli edhe studentët janë pjesë e GVB-ve për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit. Këto janë të pasqyruara edhe në faqen e NJSBC <sup>452</sup> .			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<sup>447</sup> <https://qac.beder.edu.al/>.

<sup>448</sup> <https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem>.

<sup>449</sup> <https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports>.

<sup>450</sup> <https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions>.

<sup>451</sup> Evidencia nr. 115. Plani i masave për plotësimine rekomandimeve të BA për institucionin.

<sup>452</sup> <https://qac.beder.edu.al/activities>.



## PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “INFORMATIKË EKONOMIKE”

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Ndërtimi i institucionit dhe i programeve të studimit mbi *bazën e një vizioni, misioni dhe plani të zhvillimit strategjik* të qartë, të plotë, dhe bashkëkohor.
2. *Ekzistenza e një kornize ligjore rregullatore* e cila orienton zhvillimin e programit, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të KU “Bedër” me vizionin dhe misionin e tij.
3. *Program studimi i hartuar në përputhje me nevojat e tregut*, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës, si dhe duke integruar përvojën më të mirë bashkëkohore të huaj dhe vendase.
4. *Një kurrikul e balancuar* që ndërthur në mënyrë proporcionale fushat e Informatikës dhe Ekonomisë, teorinë dhe praktikën dhe përmbush nevojat aktuale dhe projekzionet për nevojat e ardhshme të tregut të punës.
5. *Personeli akademik efektiv* i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ka nivel të lartë të përgatitjes profesionale dhe eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në profilin përkatës.
6. *Personeli me kohë të pjesshme dhe lektorët e ftuar* që vijnë nga institucione dhe fusha të ndryshme, ekonomia dhe informatika, ofrojnë në auditor një qasje praktike, duke i orientuar më mirë studentët drejt përvetësimit të kompetencave profesionale.
7. *Përparësia dhe rëndësia kushtuar kërkimit shkencor.* Përfshirja e personelit akademik në projekte të ndryshme kërkimore dhe sociale, në bashkëpunim me institucione të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këto projekte parashikohet dhe përfshirja aktive e studentëve. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit nxit në vazhdimësi përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor.
8. *Bashkëpunimi i institucionalizuar* me IAL, institucione të administratës publike, biznese, dhe kompani të fushës së informatikës dhe të ekonomisë. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi KU “Bedër” realizon objektivat për praktikën, kërkimin, ndarjen e përvojave dhe punësimin e të diplomuarve.
9. *Programet e mobilitetit Erasmus+* të mundësuara nga marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitetet të huaja favorizojnë krijimin e eksperiencave të reja për stafin dhe studentët.
10. *Infrastrukturë logistike, IT dhe sistemi i automatizimit (BIS).* Administrim tërësor online i të dhënavë nga njësítë bazë dhe kryesore rrit cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve, duke i përfshirë transparentëndaj tyre, duke i ardhur në ndihmë personelit dhe stafit akademik.
11. *Auditorë të hapur* për përfaqësues të institucioneve, organizatave dhe kompanive të ndryshme shqiptare e të huaja. Larmishmëria e të ftuarve nxit studentët për t'u përfshirë në mënyrë më të drejtpërdrejtë në jetën profesionale.
12. *Pranimi i studentëve bazuar në kriteret e cilësisë.* KU “Bedër” zbaton kriteret e zakonshme për pranimin e studentëve. Bursat e ekselencës janë mundësi për të rritur cilësinë e studentëve në fazën e pranimit.



13. *Vëmendje e kushtuar ndaj çështjeve me karakter social.* KU "Bedër" u ka kushtuar një rëndësi të veçantë studentëve me aftësi ndryshe si dhe studentëve të cilët vijnë nga shtresa të nënperfaqësuara. KU "Bedër" ka ndjekur një politikë përfshirjeje aktive të studentëve në aktivitete të ndryshme me karakter social dhe sensibilizues.
14. *Përfshirje e studentëve në vendimmarrje.* Përmes përfshirjes së studentëve në organe të ndryshme kolegiale vendimmarrëse, KU "Bedër" u ka mundësuar atyre jo vetëm të informohen rrëth zhvillimeve të institucionit, por gjithashtu të kenë mundësinë të jenë pjesë e vendimmarrjes.
15. *Kombinim i standardeve akademike me aplikimet e botës reale.* Programi i studimit respekton standarde akademike, duke i lidhur ato me aplikimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe të ekonomisë. Gërshtetim harmonik mes aspektit teorik dhe atij praktik gjatë realizimit të programit të studimit. Për nga vetë natyra e kurrikulës së programit, është e rëndësishme që studentët të marrin në mënyrë të sinkronizuar dijet teorike dhe praktike.
16. *Planifikim i mirë i karrierës profesionale,* i cili nis që me praktikat e organizuara dhe koordinuara nga departamenti në bashkëpunim të ngushtë me zyrën për planifikimin e karrierës. Angazhimi i përfaqësuesit të departamentit pranë zyrës së planifikimit të karrierës përbën një avantazh për studentët. Po ashtu, edhe përfshirja e profesionistëve të fushës në procesin mësimdhënës si asistent lektorë apo të ftuar, ka ndikuar pozitivisht në planifikimin e karrierës për studentët e departamentit.
17. *Institucionalizimi i sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë* ka mbështetur sigurimin e cilësisë. Vlerësimi i brendshëm është bërë pjesë integrale e veprimtarisë së KU "Bedër", Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit dhe Departamentit të Ekonomisë dhe Biznesit.
18. *Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit* mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm të njohurive. Vlerësimi i vazhdueshëm rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit dhe ka natyrë stimuluese e nxitëse.
19. Bibliotekë fizike tradicionale dhe online me literaturë të pasur, si dhe anëtarësim në platforma digitale si JSTOR në fushën e ekonomisë dhe të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.
20. *Regjistrimi i studentëve të huaj* i jep një dimension ndërkombëtar programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".
21. *Politikat e bursave të miratuara* nga KU "Bedër" ofrojnë mbështetje financiare për të tre vitet e studimit në programin Bachelor në "Informatikë Ekonomike".

#### Pika të dobta

- Numri i lartë i institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri rrit konkurençën midis IAL-vëjës rekrutimin e studentëve të rinj.
- Numri në rënje i maturantëve të cilët aplikojnë për ndjekjen e studimeve universitare dhe të një programi studimi ne Shqipëri.
- Rënje e interesit të studentëve ndaj librit dhe të lexuarit në përgjithësi. Të ndikuar nga zhvillimet teknologjike dhe stili i komunikimit në hapësirën virtuale, studentët e rinj nuk



tregojnë interesin e duhur për librin dhe të lexuarin.

### **Rekomandime**

1. Rritja e pjesmarrjes aktive në projekte dhe nisma të iniciuara dhe të finançuara nga BE

### **Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Economic Informatics"**

#### **Strengths and affirmations**

1. Establishment of the institution and designation of the study programs based on a *clear, comprehensive and contemporary vision, mission and strategic development plan*.
2. *The existence of an elaborate regulatory legal framework* that aligns the program, with the strategic development plan of "Bedër" University College, its vision and mission.
3. *The conceptualization of a study program designed in alignment with the market needs for professionals of the field*, the objectives of higher education reform in the country and the Bologna Process. A study program integrating the best contemporary foreign and domestic experiences.
4. *A balanced curriculum* that proportionally combines the fields of Information Technology and Economics, theory and practice thereby meeting current needs and the projections of future labor market needs.
5. *Full-time academic staff* engaged in lecturing the Bachelor Study Program in Economic Informatics has a high level of professional training and long experience in the field of teaching and research in the respective profile.
6. *Part-time staff and guest lecturers* coming from different institutions and fields, both from the economy and informatics field, are distinguished for adopting in lecturing and in the seminars a practical and professional approach that better orientates students towards the mastery of professional competencies.
7. *Priority and importance is attributed to scientific research*. Academic staff is engaged in various research and social projects, implemented in collaboration with important national and international institutions. The Department of Economy and Business is constantly promoting the active involvement of students in scientific research, professional and social projects.
8. *Institutionalized cooperation* with HEIs, public administration institutions, businesses, and companies in the field of economics and information technology. Through this cooperation "Bedër" University College achieves its institutional objectives regarding ~~internship~~ opportunities for students, student involvement in research and shared professional experiences and employability of graduates.
9. *Erasmus+ mobility programs* enabled by cooperation agreements with foreign Universities favor the creation of new experiences for staff and students.
10. *Logistics, IT and Beder Informative System (BIS) infrastructure*. There is a *comprehensive* online management of data from departments, faculties and administrative units which contributes to the increase of the quality of services to students and transparency towards them, thereby assisting both administrative staff and academic staff.

11. *Application of an open door, and open lecture policy in inviting for guest lectures* representatives of various Albanian and foreign institutions, organizations and companies. The diversity of the guests encourages students to become more directly involved in professional life.
12. *Admission of students based on quality criteria.* "Bedër" University College applies a series of selective quality criteria for student admission. Excellence Scholarships are an opportunity for the institution to increase the quality of the enrolled students.
13. *Commitment and attention to social issues.* "Bedër" University College has given special importance to students with disabilities as well as students coming from marginalized or underrepresented strata. "Bedër" University College has been following an active policy of engaging students in various social awareness-raising activities.
14. *Involvement of students in decision-making.* Through the involvement of students in various collegiate decision-making bodies, "Bedër" College has enabled them not only to be informed about the developments of the institution, but has also empowered them to be part of the decision-making process.
15. *Combining academic standards with real-world applications.* The study program respects academic standards, connecting them to applications in the field of information and communication technology and economics. There is a harmonious and synchronous intertwining between the theoretical and practical aspects in the organization and the implementation of the study program. The curriculum of the program provides for the attainment of theoretical and practical knowledge and skills in a synchronized mode.
16. *Good professional career planning practices,* initiated by the department in close cooperation with the office of career planning. The engagement of the department representative at the office of career planning represents an advantage for students. Also, the involvement of professionals in the teaching process as lecturers or invited lecturers has positively affected career planning for the students of the department.
17. *The institutionalization of the internal quality assurance system* has supported quality assurance. Internal evaluation has become an integral part of the activity of "Bedër" College in general, and the Faculty of Technology and Business and Department of Economy and Business in particular.
18. *The assessment of the student's academic progress* is based on the principle of continuous formative assessment. Continuous evaluation increases the level of objectivity and transparency in the student's assessment and is stimulating for them.
19. *The existence of a traditional and online physical library with rich literature resources*, as well as membership in digital platforms such as JSTOR in the field of economics and information and communication technology.
20. The registration of foreign students gives an international dimension to the Bachelor study program in "Economic Informatics".
21. Scholarships offered by KU "Bedër" provide financial support for the three years of study in the Bachelor study program in "Economic Informatics".

#### Weak points


- The high number of higher education institutions in Albania increases competition among HEIs in recruiting new students.



- The declining number of graduates applying to pursue university studies and study programs in Albania.
- The students' interest in reading books in general. Influenced by technological developments and the increased trend of communication through the virtual space, young students do not show much interest in books and reading.

**Recommendations**

1. Increase active participation of the institution and the department in EU-initiated and funded projects and initiatives



## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushe n pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				<b>X</b>
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				<b>X</b>
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				<b>X</b>
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				



## SHTOJCA Tabelat përbledhëse

Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)

Tabela 1

IAL	Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit (Viti akademik 2023 - 2024)					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i Pndihmës Akademik	
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada		
